

UDHËZIME
**PËR TRASHËGIMINË NDËRTIMORE
NË DHE PËRRETH POGRADECIT,
NË ANËN SHQIPTARE TË LIQENIT TË OHRIT**



UDHËZIME

**PËR TRASHËGIMINË NDËRTIMORE
NË DHE PËRRETH POGRADECIT,**
NË ANËN SHQIPTARE TË LIQENIT TË OHRIT

"This publication has been produced with the assistance of the European Union. The contents of this publication are the sole responsibility of the authors and can in no way be taken to reflect the views of the European Union"

"The designations employed and the presentation of material throughout this publication do not imply the expression of any opinion whatsoever on the part of UNESCO concerning the legal status of any country, territory, city or area or of its authorities, or concerning the delimitation of its frontiers or boundaries. The ideas and opinions expressed in this publication are those of the authors; they are not necessarily those of UNESCO and do not commit the Organization."

TABLE OF CONTENTS

Acknowledgements, Foreword and introduction(s) (Why and what)	
I. History and Territorial approach (Settlements and their layout /structure/ organization)	
II. Planning and regulations (incl. transformation & bad examples)	
III. Building typologies (The building morphologies and their structure)	
IV. Introductory principles : traditional measurements, diagnosis, and maintenance	
V. Building techniques, by categories - Elements of the building and associated crafts and repair works	
1. Walls & vertical structures	
2. Floors, horizontal structures and ceilings	
3. Roofing structures and coverings (incl. ridges, gutters, chimneys etc.)	
4. Joinery (doors, windows ...), wooden stairs, balconies, and ironworks	
5. Mortars, plasters and finishings	
6. Technical installations	
VI. Bibliography	

0.1 HISTORIA DHE QASJA TERRITORIALE

Territoret përreth liqenit të Ohrid ka qënë banuar qysh në periudhat më të hershme të historisë së shoqërisë njerëzore. Fillimet e veprimtarisë njerëzore në këtë pellg datojnë në epokën e Neolitit të Vonë (6000-2000 vjet para-Krishtit) me vendbanimet palafite mbi liqen, gjurmë të cilave janë gjetur në Gradishtën pranë Peshtanit, në Gadishullin e Linit dhe në bregun e Tushemishtit. Në vazhdim të historisë, në mijëvjeçarin e parë para Krishtit, këto territore kanë qënë të banuara nga fiset ilire të Enkelejve dhe Desareteve, gjë që e vërtetojnë edhe zbulimet arkeologjike të vendbanimeve të ndryshme në Blacë, Tushemisht, Selcë e Poshtme, Lin, Kalaja e Pogradecit etj. Këto fise pellgun ujëmbledhës të liqenit të Ohrit e quanin 'Gropa', prej ku morrën emrin edhe disa nga sundimtarët e këtij rajoni në mesjetë.

Një nga vendbanimet më të hershme që ruhet sot në bregun shqiptar të liqenit të Ohrit është një vendbanim i fortifikuar, i njohur si Kalaja e Pogradecit, i cili u formua mbi një kodër dominuese në breg të liqenit, rreth 205m mbi nivelin e tij (889m mbi nivelin e detit) rreth shekullit V para Krishtit. Gjurmët e mureve mbrojtëse të këtij vendbanimi mund të shihen edhe sot, ndërsa jetëgjatësia e tij u shtri në rreth 1400 vjet. Në vitet e mëvonshme vendbanimi u shtri jashtë mureve fortifikues, fillimisht në rrëzë të tyre e më vonë poshtë kodrës, duke i dhënë jetë qytetit të sotëm të Pogradecit. Vetë fjala Pogradec vjen nga sllavonishtja e vjetër pod gradec = poshtë qytetit, ose nën-qytet.

Gjetjet arkeologjike tregojnë se në vendbanimet e tjera përreth liqenit, që konsiderohen edhe si më të vjetrat, si në Lin, Tushemisht, Udënisht, Starovë, Peshkëpi, Vërdovë, etj., banorët e tyre janë marrë kryesisht me peshkim, bujqësi, blegtori dhe mezeje të ndryshme, duke pasur mardhënie të vazhdueshme me të gjitha vendbanimet e tjera fqinje përreth liqenit. Kjo mbështetet edhe nga tiparet e trashëgimisë ndërtimore të këtyre vendbanimeve, të cilat nuk dallojnë thelbësisht nga ato të rajonit.


Sot, në pjesën shqiptare të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Ohrit ndodhen 3 vendbanime në breg të liqenit, që lagen prej tij: Lin, Pogradec, dhe Tushemisht; dhe 12 vendbanime në pjesën kodrinore të bregut: Udënisht, Piskupat, Buqezë, Çervenakë, Mëmëlisht, Vërdovë, Rëmenj, Buçimas, Gështenjas, Gurra, Bahçallëk, dhe Peshkëpi. Thuajse të gjitha këto vendbanime kanë pasur një zhvillim të vullshëm gjysmëshekullin e fundit, ku ndërtimet e reja kanë transformuar ndjeshëm peisazhin përreth liqenit. Nuk është vështirë të vëresh se i gjithë ky transformim është kryer e po kryhet në mungesë të plotë të një planifikimi urban dhe pa respektuar atë çka është trashëguar nga veprimtaria ndërtimore e banorëve parardhës të këtij pellgu. Kjo ka sjellë si pasojë zhdukjen e shumë ndërtimeve me vlera arkitekturale, të cilat ishin pjesë e memories historike të banorëve të këtyre vendbanimeve. Sot, nga të gjitha vendbanimet e ndodhura në pjesën shqiptare të bregut të liqenit, të vetmet vendbanime që ruajnë ende vlera të trashëgimisë ndërtimore janë ato që lagen nga ujërat e tij: Lin, Pogradec dhe Tushemisht. Në këto vendbanime ruhen ndërtime, apo pjesë ndërtimesh, që na japin mundësinë për të rikrijuar imazhin e karakterit të tyre ndërtimor, të asaj që e konsiderojmë arkitekturë tradicionale, dhe cilat kanë qënë tiparet dalluese që këto vendbanime kanë pasur në të shkuarën.

1.1 VENDBANIMET PËRRETH BURIMEVE UJORE - LAGJA E VJETËR NË POGRADEDEC - LAGJA E “BURIMEVE”


Fillesat e qytetit të sotëm të Pogradecit duket se kanë qenë në lagjen e saj më të vjetër poshtë kalasë. Banesat e para në këtë lagje duhet të kenë filluar të ndërtohen rreth shekullit 17-18, kur nën klimën e një lloj stabilizimi ekonomik vendbanimi filloi të zgjerohej jashtë mureve rrethues të ‘qytezës’ në majë të kodrës dhe të merrte formë poshtë saj. Lagja mori emrin si “Lagja e Burimeve” pasi ajo u ngrit përreth disa burimeve të bollshme ujërash të kulluara, duke formuar kështu bërthamën e qytetit të ardhshëm. Në këtë lagje ka dy burime kryesore, të cilat përbëjnë qendrën e saj. Sot këto burime quhen “Burimet e Toplecit”. Megjithatë banorët e parë ishin të krishterë kisha nuk është elementi kryesor kompozicional i qendrës së tyre të vendbanimit, por uji. Kisha duket se është ndërtuar shumë më vonë, kur vendbanimi kish filluar të zgjerohej me të ardhur nga vendbanimet përreth.

Siç shihet edhe sot, banesat më të vjetra janë të vendosura përreth të dy burimeve të ujit, duke lënë një hapësirë të nevojshme për përdorimin e tyre. Përveç ujërave të pijshëm që merreshin aty, në burimet kryheshin edhe aktivitete të tjera si larja e enëve, e veshjeve, e qilimave, etj. Ujërave u lihej kalim i lirë në mes të rrugës, e cila ishte e shtruar me kalldrëm, por pa trotuare, me një kullim në mes, që i shpinte ujërat drejt lumit, apo liqenit.

Lagjia nuk dallohet për ndonjë sistem të rregullt urbanistik. Rrugët kanë ndjekur rrjedhën e ujërave në terren, i cili ka një me pjerrësi të lehtë dhe kryqëzohen herë pas here me rrugë të tjera tërthore, duke kufizuar kështu parcela ndërtimi me forma të çrregullta. Sipërfaqja e kufizuar e truajve dhe dendësia e banesave flet për një ekonomi më tepër zejtare e tregëtare se sa bujqësore të këtij vendbanimi. Banesat ngriheshin përgjatë rrugës në të dy anët e saj, me njerën faqe në rrugë duke lënë shpesh oborret e tyre në shpinë. Hyrja në banesë bëhej drejtpërdrejt nga rruga, në një korridor të gjerë, në fund të të cilit kishte gjithmone një dalje në oborrin e pasëm të banesës. Banesat



zakonisht ishin dy dhe tre katëshe. Pamjet e tyre nga rruga kishin disa elemente karakteristike: në katin përdhes, i cili ndërtohej kryesisht me mur guri theksohej një derë e harkuar, që shoqërohej me një ose dy dritare anash saj; në katin e parë, i cili shpesh edhe ky ndërtohej me gurë, zakonisht kishte një rresht dritarësh pak më të mëdha se ato të katit përdhes; ndërsa kati i dytë, i cili ishte më i lehtë pasi ndërtohej me konstruksion druri (çatma) shpesh dilte pjesërisht mbi rrugë, mbi konsola druri dhe dekorohesh me fashatura druri anash tij, rrotull dritareve dhe në strehët e çatisë. Këto dalje, që përsëriteshin thuajse në mënyrë ritmike në çdo banesë, me dy apo tre kate, çka i jepte rrugës një pamje shumë piktoreske, ku loja e volumeve dhe planeve të mureve, që çaheshin nga hapësirat e dymve e dritareve, ishte në harmoni të plotë me kontrastet e teksturave dhe ngjyrave të materialeve përbërës: gurë, dru e gëlqere.



Evidentim i ndërtimeve trashëgimi ne Pogradec Lagja e Burimave




Evidentim i ndertimeve trashegimi ne Pogradec Laga "Naim Frasheri"





Burimet e Toplecit. 1934



Burimet e Toplecit sot.






Rrugica në lagjen e vjetër të Burimeve

VANDBANIMI I TUSHEMISHTIT

Formimi i vendbanimit të Tushemishtit duket se ka qenë disi i ngjashëm me atë të lagjes së vjetër të Pogradecit, Lagjen e “Burimeve”. Banesat e para janë ndërtuar mbi kodrën pranë një burimi të bollshëm uji, maja e së cilës zotërohet edhe sot nga kisha. Ndonëse ndërtimi i sotëm është i ri, ai është ngritur mbi themelet e një kishe shumë të vjetër. Kisha ka qenë dikur edhe elementi qendror i vendbanimit. Rrugët zbresin drejt burimit, përreth të cilit është lënë një hapësirë ??e mjaftueshme për një shesh qendror. Vendbanimi më tej është zhvilluar rreth këtij sheshi qendror në një terren pjesërisht kodrinor e pjesërisht të sheshtë. Duke qenë se terreni është mjaft i pasur me burime uji dhe vijat e rrjedhjes së tyre, banesat janë vendosur lirshëm rreth e rrotull kësaj bërthame, në mënyrë të çrregullt dhe pa ndjekur ndonjë skemë urbane. Disa prej këtyre banesave, ndoshta edhe me përmasa të mëdha, duke plotësuar nevojat dhe kërkesat e mënyrës së atëhershme të jetesës kanë siguruar hapësirë ??të konsiderueshme toke përreth tyre, duke krijuar oborret të mëdha, çka tregon se veprimtaria e banorëve të tyre ishte e lidhur ngushtë me ekonominë bujqësore. Banesat vendoseshin pranë rrugës, duke lënë pas dhe anash hapësirën e oborreve. Disa nga banesat e vjetra që kanë arritur deri në ditët e sotme tregojnë se krahas vendosjes të distancuar nga rruga, ka pasur edhe banesa që dilnin drejt për drejt mbi rrugë, ku zakonisht dilte faqja kryesore. Banesa më e vjetër e Tushemishtit, e cila sot ka mbërritur e përgjysmuar, ndonëse ka pasur një sipërfaqe të madhe banimi, ka edhe një dalje konsol të katit të sipërm mbi rrugë, çka tregon se tipi tradicional i banesës ishte tepër prioritar edhe kur hapësira mundësonte zgjidhje të ndryshme. Në këtë banesë vihet re përdorimi i gjerë i elementëve arkitekturalë prej druri të tipit tradicional me çardak, pamvarësisht se banesa është e mbyllur. Strukturat e çatmasë janë të pranishme gjerësisht edhe në tipet e mëvonëshme të banesave deri në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit 20.



Evidentim banesash ne Tushemisht



Rritja e vendbanimit sidomos mbas Luftës I Botërore diktoi zhvillimin e tij edhe përgjatë rrugës që e lidh këtë vendbanim me rrugën kryesore nga Pogradeci. Këtu banesat janë ndërtuar në të dy anët e rrugës, duke nxjerrë ballin ndaj saj, por duke kthyer shpinën vijës së ujit që rrjedh nga burimi në liqen. Banesat janë të vendosura në varg dhe shumica e tyre janë të ndara nga njëra tjetra me nga një hapësirë ??të ngushtë midis tyre.

1. VENDBANIME NË BREG TË LIQENIT - LIN

Vendbanimi i Linit, ndonëse është më i vogli në madhësi, paraqet një formacion më të organizuar të hapësirës dhe një nivel më të lartë të bashkëjetesës së komunitetit krahasuar me të gjitha vendbanimet e tjera në pjesën shqiptare të Liqenit të Ohrit. I vendosur në këmbët e një kodre shumë të lartë në gadishullin me të njëjtin emër, vendbanimi Lin ka pasur fillimisht një hapësirë ??shumë të kufizuar në dispozicion, vetëm pjesën ku rrëza e kodrës prek liqenin. Vendbanimi u zhvillua përgjatë një rripi shumë të ngushtë toke me një pjerrësi të lehtë drejt liqenit dhe që kufizohet nga shkëmbinj të thepisur të kodrës që ngrihen si “mur” përpjetë në njërën anë dhe nga vija ujore e bregut të liqenit nga ana tjetër. Në mes të këtij brezi të ngushtë toke dhe përgjatë gjithë gjatësisë së tij, zhvillohet një rrugë, e cila shërben si boshti kryesor gjatësor i vendbanimit. Ky ndërpritet thuasht rregullisht nga rrugë të shkurtëra tërthore, në formë rrugicash, që fillojnë nga “muri” shkëmbor dhe përfundojnë drejt në liqen. Ato krijojnë parcela të rregullta ndërtimi të mbushura me dy rreshta shtëpish që vendosen duke i kthyer shpinën njëra tjetrës dhe ballin ndaj rrugicës. Banesat janë ndërtuar në rresht, njëra pas tjetrës, shpesh duke prekur njëra tjetrën, apo dhe duke u mbështetur në to, pasi shumë prej tyre kanë edhe mure të përbashkëta. Në pjesën e mbrapme të tyre krijohen hapësira të ngushta, në të cilat komunikohet vetëm nëpërmjet banesës dhe jo nga rruga, apo rrugica. Këto hapësira mbrapa banesave nuk kanë gardhe e as kufij pronësie dhe familjarët mund të lëviznin lirisht nëpër to deri në liqen. Duket se ato u shërbenin vetëm banorëve të grupit të banesave që e krijonte këtë hapësirë dhe kjo jo vetëm për komunikim mes tyre, por edhe për shpłodhje, biseda, etj. Kjo konfirmohet nga prania e ballkoneve prej druri në pjesën e prapme të këtyre banesave, gjurmët e të cilave dallohen qartë edhe sot. Vlen të theksohet se megjithëse këto ballkone ndërtoheshin në një hapësirë ??shumë të ngushtë, ato jepnin një mundësi për të parë “pak” liqen. Sigurisht funksioni i tyre primar ishte që në to të ndereshin peshq për tu tharë, apo të pregatiteshin zahire, pasi këto hapësira qendronin të freskëta prej erërave që frynin nga liqeni. Ky është tregues i një manaxhimi shumë të mirë të truallit, duke e shfrytëzuar maksimalisht atë dhe njëkohësisht flet për një mentalitet të shkëlqyer në lidhje me bashkëjetesën e këtij komuniteti, ku ekzistonte një lloj mirëkuptimi mbi pronësinë dhe hapësirën e përbashkët, me qëllim shfrytëzimin sa më të mirë të truallit të vendbanimit.





Sistemi rrugor në fshatin Lin.



Banesa tradicionale me vlera arkitekturale.



Pamje e përgjithëshme e fshatit Lin në vitin 1940. Foto M. Cici.


Pamje e përgjithëshme e fshatit Lin sot.





Rrugë kryesore në Lin.





Hapësira e përbashkët mbrapa banesave.

Rrugët dhe rrugicat e vendbanimit kanë qënë të shtruara me kalldrëm, me gurë të vegjël të nxjerra nga shkëmbinjtë aty pranë. Ato nuk kishin trotuare anash, por kishin nga një kullim të lehtë në mes, që shkarkonte ujërat e shiut në liqen. Pothuajse të gjitha rrugët e rrugicat janë të hijeshuara nga “tenda” me hardhi, jargavanë e triandafila, duke e bërë shumë tërheqëse dhe të këndëshme kalimin nëpër to.





Rrugë të shtruara me kalldrëm në Lin

VENDBANIMET MALORE

LLËNGA

Llënga është një fshat malor në një grykë të gjelbëruar me pyje mes maleve të Senies, Valamarës e Nikës pranë vendit ku buron lumi Shkumbin. vendbanimi i Llëngës është i pozicionuar buzë trasesë së rrugës antike “Egnatia” dhe lidhej me të me një degëzim, fragmente me gurë të mëdhenj të të cilit mund të shihen edhe sot në grykën e Llëngës, një kanion me gjerësi 15-20 m, lartësi 50-60 m dhe gjatësi 1 km ku kalon lumi Shkumbin. Më tej pranë fshatit Golik ndodhet edhe një urë e ndërtuar në periudhën romake Banorët e Llëngës kanë qenë kryesisht blegtorë dhe tregtarë.

Zhvillimin më të madh Llënga e pati në shekujt 17-18, kur thuhet se numëronte mbi 3000 banorë. Ndërsa në vitin 1905, sipas defterëve të taksave të administratës turke, kishin mbetur vetëm 100 familje.

Në shpatin e një mali dominues në veri të Llëngës, ndodhet manastiri i Shën Marenës. Kisha e këtij manastiri është ndërtuar rreth vitit 1666 dhe e pikturuar në vitin 1754 me afreske nga dora mjeshtërore e Kostandinit nga Shpati i Elbasanit.

E pasur me pyje të shumta dhe e mënjanuar nga qendrat e mëdha Llënga zhvilloi një arkitekturë banimi të mbështetur kryesisht në të vetmin material më të mundëshëm rrethanor, drurin.




Vendosja e banesave është përgjithësisht e çrregullt, duke ndjekur pjerrësinë e terrenit dhe pranë ujërave. Në pjesën më të lartë të një kurrizi që ndan dy lagjet kryesore ndodhet kisha.

ZHVILLIMI I PLANIFIKUAR

PERIUDHA 1920-40. PLANI GARIQUE




PLANI RREGULLUES I QYTETIT TE POGRADECIT, VITIT 1927



Përprojekjet e para për një zhvillim të planifikuar në qytetin e Pogradecit datojnë mbas përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe lidhen me emrin e inxhinierit arkitekt francez Garrique, i cili pasi shërbeu si intendent i trupave franceze gjatë luftës vendosi të qendrojë në këtë qytet mbas saj. Në vitin 1927 Garrique hartoi një plan rregullues për zhvillimin urban të qytetit të Pogradecit duke u bazuar në një nga konceptet e e përparuara të kohës, i cili kish provuar epërsi të dukshme në zhvillimin e shpejtë të qyteteve gjatë shekullit 19 dhe fillimit të shekullit 20 në Europë dhe kontinentin e ri. Ky ishte sistemi ortogonal, ku rrugë të drejta ndërpresin rregullisht njera tjetrën duke krijuar parcela ndërtimi drejtkëndore. Plani rregullues Garrique mernte përsipër të rregullonte sistemin ekzistues, të çrregullt e kaotik të qytetit dhe ta zgjeronte atë në hapësirat përreth të pabanuara më parë. Ai përpikëj të ratifikonte rrugët e shtrembta e të ngushta ekzistuese, duke i zgjeruar e drejtuar ato në përputhje me kërkesat e kohës (futja dhe përdorimi i automobilëve në këtë kohë premtonte një zhvillim më të madh për të ardhmen dhe kërkesa të reja në gabaritet e sistemit rrugor). Garrique gjithashtu krijonte sheshe dhe qendra funksionale në kryqëzimet kryesore, sidomos përreth atyre ndërtimeve institucionale publike, që ishin në atë kohë, kishës, xhamisë, bashkisë. Garrique planifikoi dy arterie kryesore që fillonin në hyrjen perëndimore të qytetit, duke u ndarë nga njera tjetra, dhe pasi e përshkonin tejprtej atë, njera në vijë të drejtë që shkonte buzë liqenit dhe tjetra e harkuar që i afrohej lagjes së vjetër të Burimeve, bashkoheshin përsëri në dalje të tij për të vazhduar në rrugët drejt Korçës ose Tushemishtit. Brenda dhe jashtë këtyre arterieve kryesore planifikohej një rrjet ortogonal rrugor që kufizonte parcela të rregullta drejtkëndore ndërtimi. Shtrirja e qytetit me parcela të reja ndërtimi sipas planit Garrique parashikohej të ndodhte kryesisht në pjesën lindore, përgjatë bregut të liqenit. Këtu parcelat parashikoheshin të ishin me përmasa disi më të mëdha se ato të qendrës, ndërsa rrugët më të gjera. Kjo provon se Garrique kishte një koncept vizionar për zhvillimin e qytetit, ku përdorimi i automobilëve dhe zhvillimi i tregëtisë do të diktonin kërkesa të reja. Plani Garrique parashikonte gjithashtu një sistemim modern të lumit, duke shmangur dredhëzimet dhe çrregullimet e shtratit të

Rruga e re sipas planit Garrique. Foto M. Cici 1940.






Projekte vilash nga Garrique.

tij. Në planin Garrique shohim për herë të parë edhe konceptet për krijimin e një lulishte publike anës liqenit dhe atë të një terreni të madh sportiv i emërtuar në plan si “vend rezervuar për sport”, aty ku sot ndodhet stadiumi i qytetit.


Garrique filloi të zbatojë planin e tij menjëherë me aksin kryesor, rrugën ..., që sot mban emrin “Reshit Çollaku”, e cila ishte e para rrugë e drejtë që përshkonte tej-për-tej qytetin përmes kopshteve të mëdha të banesave të pasura, por të vendosura në mënyrë të çrregullt gjatë dekadave parardhëse. Megjithëse ishte një kohë e turbullt dhe e pasigurt Garrique arriti të bindë pronarët e fuqishëm të qytetit se hapja e kësaj rruge do të sjellë zhvillim. Dhe ashtu ndodhi. Rruga u zbatua krejtësisht sipas planit Garrique, një rrugë e drejtë me një gjerësi që i tejkalonte disa herë ato të rrugëve ekzistuese të qytetit. Të njëjtën gjë ai bëri edhe me aksin tjetër kryesor, rrugën ... si dhe lidhjen tërthore të këtyre dy akseve me rrugën që sot mban emrin “Naim Frashëri”. Këto akse kryesore lehtësuan së tepërmi lëvizjen në qytet, duke i dhënë një impuls zhvillimit të tij me ndërtime të reja në të dy anët e tyre. Të ndihmuara edhe nga bumi ekonomik i viteve 1930’ përgjatë këtyre akseve kryesore filluan të ndërtoheshin hotele, dyqane, ndërtime administrative dhe banesa të reja.

Plani Garrique u shoqërua me futjen e një arkitekture bashkokohore të huazuar kryesisht nga ajo italiane e franceze. Ndërtimet e shumta megjithëse ishin të shumëllojëshme si për nga funksioni ashtu edhe për nga kërkesat arkitekturore kishin diçka të përbashkët: ato shprehnin kamje dhe modernitet, cilësi këto që shumë shpejt u bënë kërkesat më të parapëlqyera për shtresën e mesme që ishte vazhdimisht në rritje e që bëhej gjithnjë e më e begatë. Duket se projektet e para u bënë nga vetë Garrique, ndërsa më vonë, me rritjen e shpejtë të volumit të ndërtimeve filluan të importohen projekte të gatëshme më së shumti nga Italia e më pak nga Franca.



Projekt hoteli nga Garrique 1932

Një nga ndërtimet publike më të rëndësishme në Pogradec ishte kinemaja e qytetit, e cila u projektua nga Garrique në vitin 1932.



Projekt i kinemasë në Pogradec. Garrique 1932.



Tipet dhe modelet e reja të ndërtimeve u shoqëruan edhe me një teknologji të re në ndërtim. Thua se të gjitha ato dallohen për përdorimin e materialeve dhe teknikave të reja në ndërtim, duke lënë pas, ose duke i lënë shumë pak vend përdorimit të teknikave e materialeve tradicionale. Ndër materialet e reja që u përdorën në këtë kohë dallohen sidomos ato të fabrikuara, siç ishin tullat e tregullat e standarteve të reja, përdorimi gjerësisht i sipërfaqeve më të mëdha me xhama, e pak më vonë përdorimi gradualisht në rritje i çimentos, hekurit e betonit. Teknologjia e re për prodhimin e tullave të pjekura në furra u mundësua nga importimi i linjave, fillimisht të thjeshta e më pas ngritja e disa punisheteve me standarte më të larta për të përballuar kërkesat gjithmonë në rritje për ndërtimet e shumta.

Muret me tulla filluan të zëvendësojnë në masë ato me çatma, duke u hapur rrugë njëkohësisht mjeshtrave të rinj që e thithën shumë shpejt këtë teknologji. Muret e ndërtuara me tulla kërkonin mjeshhtëri të re dhe njohuri, jo vetëm për qëndrueshmëri, por edhe për pasurimin e pamjeve të tyre të jashtme me dekoracione të shumta në kornizimet e strehëve, dyerve, dritareve, qosheve, ndërkatave, etj. Daljet e kornizave me tulla modeloheshin më pas me suva me forma e profile të shumta sipas modeleve arkitekturale të huazuara. Tullat gjithashtu filluan të zëvendësojnë dhe të eliminojnë në masë përdorimin e drurit, si në breza, arkitrarë, korniza, etj.



PERIUDHA KOMUNISTE 1945-1990

Mbas Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes së sistemit komunist në urbanistikën dhe arkitekturën e qyteteve të Shqipërisë filluan të mbizotërojnë praktikat e huazuara nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet lindore. Elementi kryesor ishin banesat kolektive, me sipërfaqe minimale banimi dhe të zhveshura nga kërkesat arkitekturore. Modelet e projektet në të gjithë Shqipërinë serveshin nga institucionet qendrore në Tiranë të krijuara enkas për këtë punë, siç ishin Instituti i Projektimit dhe Instituti i Urbanistikës, të cilët fillimisht drejtoheshin nga arkitektë të shkolluar në Bashkimin Sovjetik, ose në vendet lindore, e që kishin sjellë me shumicë projekte e modele të arkitekturës të ashtuquajtur “socialiste”. Edhe qyteti i Pogradecit nuk mund të bënte përjashtim e të mos influencohej nga kjo arkitekturë. Rruga ..., e cila në bazë të planit Garique ishte zgjeruar dhe përshkonte gjithashtu tejprtej qytetin por me një hark të lehtë duke iu afruar lagjes së vjetër të Burimeve, ishte e para që u bë pre e ndërtimeve të shumta kolektive në të dy anët e saj. Këto ndërtime voluminoze me tre dhe katër kate, me një arkitekturë standarte me kërkesa minimale dhe për më tepër të ndërtuara në rresht njera pas tjetrës përgjatë gjithë rrugës ..., shpesh herë duke sakrifikuar e prishur edhe shumë ndërtime ekzistuese, krijojnë një imazh krejt të ndryshëm nga ai tradicional i qytetit të Pogradecit. Ato gjithashtu shërbenin si mure të larta anash rrugëve kryesore, duke mbuluar lagjet e vjetra ku mbizotëronin banesat individuale me arkitekturën tradicionale e atë moderne të viteve ‘30.

Gjatë viteve 1960, 1970 e 1980, si pasojë e rritjes së popullsisë me të ardhur nga fshatrat përreth, ndërtimet e shumta me banesa kolektive erdhën duke u shtuar dhe njëkohësisht duke pakësuar kërkesat estetike për to deri sa edhe u zhveshën krejtësisht jo vetëm nga dekoracioni, por edhe nga suvatë. Ato ndërtoheshin kudo ku gjendej ndonjë hapësirë e mundëshme dhe nuk suvatoheshin për të ulur sa më shumë koston e ndërtimit. Ky degradim ndërtimor vazhdoi deri me rënien e sistemit komunist në vitin 1990.

Foto M. Cici 1960.





Të vetmet ndërhyrje të studiuara, por gjithnjë në përputhje me konceptet e arkitekturës lindore socialiste dhe që në disa raste ishin tepër arrogante, duke mos respektuar as kërkesat minimale të peisazhit ekzistues, ishin ndërtimi i hotel Turizmit, i Komitetit të Partisë, i Pallatit të Kulturës dhe Kinemasë.

Në vitin 1979 u hartua dhe u miratua një plan rregullues i qytetit, i cili merrte përsipër hapjen e disa rrugëve të reja e të drejta përmes lagjeve të çrregullta të banimit, gjithnjë në vazhdim të konceptit të Garrique, si dhe zgjerimin e mëtejshëm të qytetit me kuartalle të reja. Ky plan krijonte edhe një zonë industriale në pjesën lindore të qytetit. Në zbatim të këtij plani u bë një ndërhyrje mjaft energjike në vitet 1980 për hapjen dhe ndërtimin e rrugës ..., që lidhte në mënyrë perpendikulare rrugën me rrugën Megjithëse rruga u projektua dhe u zbatua me gjerësi 20 m funksioni i saj mbeti i cunguar për shkak të mos-zgjidhjes teknikisht të lidhjes sa saj me rrugën ... për shkak të një disnivele prej 4 m mes tyre.

Plani rregullues i vitit 1976.



Gjithashtu, mbas krijimit dhe fuqizimit të Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe degëve të tij nëpër rrethe, filluan përpjekjet për evidentimin e vlerave në arkitekturën tradicionale dhe vënien e tyre në mbrojtje. Në Pogradec disa studime, megjithëse të shpejta, rezultuan në vënien në mbrojtje të shtetit të 7-8 banesave të vjetra, një pjesë e të cilave iu nënshtruan edhe restaurimeve. Kjo bëri të mundur ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe sidomos të autoriteteve lokale për tu angazhuar më tepër me ruajtjen e këtyre vlerave të trashëguara nga e kaluara. Rezultati ishte shpallja në mbrojtje të shtetit si “zonë muze” e Lagjes së Burimeve. Por studimet dhe punimet restauruese nuk vazhduan më tej.



Dy zonat muze në qytetin e Pogradecit.



Zona muze në Lagjen e Burimeve të Toplecit, pjesa e vjetër e qytetit.



Zona muze në të dy anët e rrugës "Naim Frashëri".

Një tjetër vendbanim, që pati disa përmirësime gjatë periudhës komuniste ishte ai i Tushemishtit. Gjatë viteve 1970' në të u ndërtuan mjaft banesa individuale, por edhe të grupuara për dy familje, të projektuara nga Institutit të Projektmeve Urbanistike në Tiranë. Ky institut krijoi disa tipe të standartizuara, të cilat mbizotëruan thuajse të gjitha ndërtimet individuale në mbarë fshatrat e Shqipërisë. Ato ishin një ose dy katëshe me një korridor qendror dhe dhomat anash tij. Forma e tyre ishte drejtkëndore ose në formë "L". Në rastet e grupimit ato ishin dy katëshe ku secila nga familjet kishte hyrje më vehte. Vendosija e banesave bëhej e rregullt duke ndjekur një plan të paracaktuar urban të miratuar në instancat përkatese qendrore e lokale.





Në Tushemisht u projektua dhe u ndërtua me banesa individuale rruga hyrëse në fshat. Banesat u vendosën në të dy anët e saj, duke lënë një oborr të vogël përpara dhe vijat e ujërave të shumta në pjesën e pasme të tyre.

Banesa të tjera individuale u ndërtuan edhe në pjesën kodrinore të Tushemishtit, duke ndjekur izoipset e saj.

Vendbanimi i Linit u prek pak ose aspak gjatë periudhës komuniste. Shumë pak nga tipet standarte të Institutit të Projektimeve Urbanistike u ndërtuan këtu. Por edhe ato pak ndërtime që u zbatuan vazhduan të ndjekin traditën e ndërtimit me gurë, ndaj edhe kontrasti mes tyre dhe ndërtimeve tradicionale është më i vogël.

PERIUDHA POST-KOMUNISTE 1990 -

Periudha mbas viteve 1990 karakterizohet si një periudhë e rritjes masive të ndërtimeve individuale, por që fatkeqësisht u shoqërua edhe me një mungesë të theksuar legjislacioni e studimesh urbanistike, varfëri profesionale projektuese, abuzivitet të autoriteteve lokale për të respektuar edhe ato pak rregulla që ekzistonin, çka rezultoi në një liri të shfrenuar dhe kaotike ndërtimi. Çdokush ndërtonte ku të mundte dhe si të mundte. Kjo solli një shpërfytyrim të madh të peisazhit të qyteteve anë e mbanë vendit, madje duke prekur edhe shumë fshatra. Agresiviteti i ndërtimeve individuale, i shoqëruar me një nivel minimal kërkesash estetike dhe profesionalizmi, duke i dhënë shumë më tepër rëndësi plotësimit të kërkesave funksionale prodhoi në mënyrë masive ndërtime të rëndomta utilitare. Ndërtime të shumta u karakterizuan nga mungesa e proporcioneve, estetikës, deformim i njohurive të teknikave të ndërtimit, ndërsa në hapësirat urbane u vu re mosrespektimi i standarteve më minimale, rrjet i çrregullt rrugor, disproporcione të theksuara volumore e shumë të mangësi të tjera. Të gjitha këto sollën pengesa serioze në rritjen dhe zhvillimin normal të qytetit, aq sa u bë shumë i vështirë jo vetëm qarkullimi në brendësi të parcelave me ndërtimeve të reja kaotike, por u vështirësua edhe jeta në to.

Mungesa e përkujdesjes nga autoritetet shtetërore dhe komunitetet lokale pati pasoja të rënda sidomos për arkitekturën tradicionale. Dobësimi i ligjit nga njera anë dhe rritja e koston për mirëmbajtjen e tyre nga ana tjetër u hapën rrugë prishjeve njera pas tjetrës të shumë ndërtimeve me vlerë, ose, në rastin më të mirë, rikonstruksioneve pa kriter dhe pa asnjë lidhje me ndërtimet ekzistuese me qëllimin e vetëm - përmirësimin e kushteve të jetesës. Gjatë kësaj periudhe u zhdukën gradualisht shumë forma, tipare dhe tipe arkitekturalë tradicionale të trashëguara me shekuj.

Edhe në rastet kur autoritetet lokale përpiqeshin të kryenin investime për përmirësimin e peisazhit urban tradicional në zona të mbrojtura ose muze, këto investime kryheshin pa marrë mendimin e specialistëve përkatës, shpesh duke mos ruajtur asgjë nga vlerat ekzistuese e duke kryer rikonstruksione tërësore me materiale krejt të reja dhe pa asnjë lidhje me ato tradicionale. Kuptohet se pasojat ishin shpërftytirimi i mazhit tradicional të ansamblit dhe krijimi i një imazhi të ri të tjetërsuar.



Rikonstruksione të kalldrëmeve në ansamblin muzeal në Pogradec që nuk respektojnë karakterin tradicional të tij.




Rikonstruksione të peisazhit urban që nuk respektojnë vlerat ekzistuese.



Rikonstruksione të kalldrëmeve në Lin që nuk respektojnë karakterin tradicional.



Ndërtime të reja dhe rikonstruksione të ndërtimeve të vjetra në hyrje dhe brenda zonës muze, të cilat janë krejtësisht jashtë kontekstit të arkitekturës tradicionale të këtij ansambli dhe asaj të qytetit në përgjithësi.



Volume të reja në zonën muze që nuk respektojnë volumet dhe vlerat arkitekturale ekzistuese.



Volume të reja në zonën muze që nuk respektojnë volumet dhe vlerat arkitekturale ekzistuese.



Rikonstruksione tërësore të ndërtimeve të vjetra me përpjekje për të ruajtur imazhin e tyre të dikurshëm, por pa studiuar karakterin e tyre.



Banesë tradicionale në Pogradec e transformuar nga shtesat dhe adaptimet pa kriter.

Ndërtime të çrregullta, pa kriter, të disproporcionuara dhe krejtësisht jashtë kontekstit të ansamblit ekzistues nuk munguan të shfaqen edhe në vendbanimet e tjera buzë liqenit, si në Tushemisht, Lin, etj.



Ndërtime jashtë kontekstit në Tushemisht.




Ndërtime të reja në Lin krejtësisht jashtë kontekstit të ndërtimeve ekzistuese dhe që nuk repsekojnë peisazhin natyror dhe atë urban.



Rikonstrukcion banese në Lin me përpjekje për të ruajtur volumet dhe imazhin ekzistues, por me rezultat negativ dhe jashtë kontekstit tradicional.



E njëjta banesë para rikonstruksionit. Foto Banimir Guši? 1947.



GM074: Houses and children at Lin on Lake Ohrid (Photo: Giuseppe Massani, 1940).



Një nga banesat tradicionale më të bukura dhe më të mëdha në Lin e degraduar gjatë përpjekejeve për rokonstrukcionin e saj. Poshtë: rikonstrukcioni virtual i saj.



KOMENTET DHE REKOMANDIMET

1. TERRITORIAL PLANNING

2 - EXISTING REGULATIONS AND FUTURE MASTER PLAN

Vendim nr. 22 dt 10.06.1994 për Vijën Kufizuese Mbrojtëse të liqenit të Ohrit

Vendimi nr 40 dt 24.06.1996 për Shtesën e Vijës Kufizuese të qytetit të Pogradecit

Vendimet: Peisazh i Mbrojtur dhe Zonat me Perparesi Zhvillimin e Turizmit 1993, Peisazh i Mbrojtur Tokësor e Ujor 1999.

Plani i Përgjithshëm Rregullues i vitit 2009 miratuar me vendim të KRRT së Bashkisë nr 51 dt. 21.12.2009

Vendimi nr.5 dt 07.11.2014 Rehabilitimi i Bregut të liqenit të Ohrit, Segmenti Lin-Pogradec

Vendim nr. 554, dt. 18.06.2015 për shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Pogradecit dhe miratimin e Rregullores për Administrimin e saj.

Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) 2018 (?)

(Këtu do të bëj disa komente mbi rregulloren e Qendrës Historike)

Hyrja në ansamblin Qendër Historike, pamja e të cilit nga rruga kryesore mbulohet nga ndërtime kolektive me volum të madh të periudhës komuniste.



3 – TRANSFORMATIONS:

KONTEKSTI URBAN DHE RËNDËSIA E RUAJTJES SË KARAKTERIT NË NJË ANSAMBLË ME VLERA TË TRASHËGUARA

KONTEKSTI

Më sipër pamë se lagjet e vjetra të qytetit të Pogradecit, të cilat mbrohen nga shteti si “zona muze” pjesë të një Qendre Historike si dhe ansamblët rurale që janë ende të pa mbrojtura në Lin e Tushemisht përmbajnë pasuri të konsiderueshme vlerash të trashëguara nga e kaluara. Në to mund të lexohet historia e zhvillimit të mënyrës së jetesës, e mentaliteteve dhe koncepteve sociale në kohë të ndryshme, rruga e civilizimit të këtyre komuniteteve, tipet dhe tiparet arkitekturës që ata kanë përdorur si dhe ecurinë e teknologjisë së ndërtimit në këtë rajon. Gjurmët e kësaj historie zhvillimi ruhen në çdo rrugë, banesë, ndërtim, element arkitektural, apo peisazh urban që sëbashku formojnë atë që quhet kontekst i ansamblit. Të kuptuarit e kontekstit të një ansambli është faktori kyç dhe thelbësor që duhet të merret parasysh në zhvillimin e mëtejshëm urban të tij.

Për fat të keq, zhvillimi i deritanishëm i këtyre ansambleve me vlera të trashëguara nga e kaluara si në qytetin e Pogradecit ashtu edhe në vendbanimet rrotull tij tregon se konteksti i tyre është kuptuar shumë pak, ose aspak nga ata që kanë pasur në dorë këtë zhvillim, arkitektë, urbanistë, autoritete vendore e qendrore. Kjo duket qartë më të shumtat e ndërtimeve, rikonstruksioneve dhe adaptimeve të kryera gjatë dekadave të fundit janë bërë krejtësisht jashtë kontekstit të këtyre ansambleve me vlera të trashëguara. Moskuptimi me dashje, apo pa dashje i kontekstit të këtyre ansambleve ka sjellë transformime negative përsa i përket ruajtjes së vlerave historike dhe peisazhit urban të trashëguar nga e kaluara. Sot këto ansamble paraqiten thujtë të përcudnuar nga ndërhyrjet e shumta pa kriter dhe krejtësisht jashtë kontekstit të trashëgimisë së tyre, aq sa në sytë e vizitorëve të zakonshëm ato duken si ansamble që kanë filluar të humbasin identitetin e tyre urban e arkitekturor.

Rikthimi i identitetit të trashëguar në këto ansamble nuk është një punë e lehtë që mund të bëhet menjëherë. Kjo kërkon angazhimin sistematik të shumë faktorëve profesionistë e vendimmarrës lokalë e qendrorë. Megjithatë për të ndihmuar sadopak në rikthimin e identitetit dhe ruajtjes së kontekstit të këtyre ansambleve po japim disa kritere që duhen pasur parasysh në zhvillimin e mëtejshëm urban të tyre.

Ruajtja e kontekstit të ansambleve me vlera të trashëguara nga e kaluara nuk do të thotë që ato të mbeten të ngrira në kohë dhe të mos ndryshojnë asnjëherë. Në fakt, mënyra më e mirë për të mbrojtur një ansambël me vlera të trashëguara është ta përdorësh atë, por në një mënyrë që të mos degradohen vlerat e tij të trashëguara. Për shembull, duke përdorur ansamble me vlera të trashëguara për qëllime turizmi apo arsimimi, shpesh sigurohen mënyra të efektshme që ato të mirëmbahen mirë dhe të kontribuojnë në mirëqenien kulturore, ekonomike dhe sociale të komunitetit.

ZHVILLIMI QË PREK NJË ANSAMBËL APO ZONË ME VLERA TË TRASHËGUARA, DUHET TË ARRIJË TË DY QËLLIME: SË PARI, TA RUAJË ATË PËR NJË KOHË TË GJATË DHE SË DYTË, TË RRIJË VLERËSIMIN E VLERAVE TË TRASHËGUARA TEK PUBLIKU.



Ndërtime të periudhës komuniste që mbulojnë ansamblin trashëgimi kulturore.

Ndërtime të periudhës post-komuniste me të njëjtin koncept të fshehjes së ansamblit trashëgimi kulturore





Ndërtime të reja në ansamblin tradicional të trashëguar krejtësisht jashtë kontekstit.



Ndërtim i ri në zemër të Qendrës Historike krejtësisht jashtë kontekstit të ansamblit

Ndërtime masive në Tushemisht që nuk respektojnë peisazhin dhe shkallën humane të ansamblit të vendbanimit



KRITERE PËR ZHVILLIM BRENDA KONTEKSTIT URBAN

Kur zhvillohet një ansambël me vlera të trashëguara, ekzistojnë disa kritere kryesore që duhet të merren parasysh nga hartuesit e këtij zhvillimi në mënyrë që ky zhvillim të mos dëmtojë vlerat e trashëguara kulturore:

1. Të kuptohet rëndësia e vlerave të trashëguara kulturore të ansamblit dhe të përdoret ajo për të informuar dhe ndikuar në planifikimin dhe hartimin e zhvillimit.
2. Të ruhen karakteristikat fizike, tiparet dhe përmbajtjet që kontribuojnë në dallueshmërinë e ansamblit me vlera të trashëguara kulturore.
3. Të ruhet potenciali historik i ansamblit.
4. Të përdoret dhe të menaxhohet ansambli me mënyra që do ta ruajnë atë edhe në të ardhmen.
5. Projektimi dhe dizajni i ndërtesave të reja, shtesave, apo strukturave plotësuese duhet ti përgjigjet rëndësisë së trashëgimisë kulturore të ansamblit.
6. Hartimi i planit të zhvillimit të ansamblit duhet të konsiderohet si pjesë integrale e mjedisit për të përjetuar rëndësinë e trashëgimisë kulturore të tij.
7. Zhvillimi nuk duhet të zvogëlojë dhe në asnjë mënyrë të shkatërrojë ndjeshëm rëndësinë e trashëgimisë kulturore.
8. Të mbahet dialog i vazhdueshëm me njerëzit dhe organizatat e interesuara për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

PLOTËSIMI ME NDËRTIME TË REJA NË LAGJET ME VLERAT TË TRASHËGUARA

Një aspekt shumë i rëndësishëm i zhvillimit në ansamble me vlera të trashëguara nga e kaluara është plotësimi me ndërtime të reja që bëhet mbi truajt të disponueshëm brenda këtyre ansambleve me tipare të formuara. Lagjet me tipare të formuara shpesh kanë një karakter të veçantë arkitekturor, i cili është rezultat i kushteve gjeografike dhe klimatike, teknikave të ndërtimeve lokale dhe materialeve si dhe i stilit të periudhës gjatë së cilës është ndërtuar ansambli. Për të ruajtur këtë karakter ndërtimet e reja duhet të jenë brenda këtij konteksti, sepse në të kundërt karakteri dhe tiparet e ansamblit do të shpërftyrohen. Që ndërtimi i ri të jetë i një plotësimi përshtatshëm dhe brenda kontekstit të ansamblit ai duhet të jetë patjetër në harmoni me arkitekturën ekzistuese përreth, duke ofruar njëkohësisht edhe zhvillime të reja rezidenciale që përfitohen nga infrastruktura ekzistuese. Idealisht, një projekt plotësimi duhet të përdorë hapësirën ekzistuese, që vihet në dispozicion dhe nuk duhet të kërkojë prishjen e ndonjë ndërtese ekzistuese. Dizajni i ndërtesës së re duhet të jetë në përputhje me linjat dhe peisazhin ekzistues të rrugëve për të ruajtur karakterin e trashëguar të ansamblit, duke adoptuar gjithashtu stilet e përshtatshme të ndërtimit, profilet, masat dhe materialet, që janë përdorur në të. Është e rëndësishme të theksohet se ndërtimi i ri nuk ka nevojë të imitojë ose të kopjojë origjinalin për të qënë në përputhje me kontekstin e trashëgimisë përreth tij. Ai duhet të jetë një projekt plotësues, i identifikueshëm si një produkt i kohës së tij, për të shmangur qartazi dhënien e një ndjenjë të rreme të së kaluarës. Një ndërtesë bashkëkohore mund të bashkëjetojë me fqinjët e trashëguar, nëse dizajni është i respektueshëm dhe inovativ. Çdo projekt është unik, një rast më vehte, dhe duhet vlerësuar në përputhje me rrethanat.


Që një projekt plotësimi të jetë i suksesshëm dhe brenda kontekstit të ansamblit me vlera të trashëguara ai duhet të marrë parasysh:

- Respektimin e vijës së ndërtimit
- Orientimin
- Shkallën
- Përqindjen
- Ritmin
- Masën
- Lartësinë
- Materialet
- Ngjyrat
- Formën e çatisë
- Detajet dhe zbukurimet
- Karakteristikat e peisazhit
- Ndërtesat ndihmëse
- Parkingun

- RESPEKTIMI I VIJËS SË NDËRTIMIT

Një projekt plotësimi duhet të respektojë largësinë e ndërtimit nga rruga dhe vijën ekzistuese të ndërtesave përreth. Është shumë e rëndësishme që pamja, apo peisazhi i rrugës nuk duhet të dominohet nga ndërtimi i ri, apo nëse ka disa, nga ndërtimet e reja.

Respektimi i linjës së fasadave të pasme nuk është aq i nevojshëm sepse ato rrallë mund të shihen nga rruga publike. Vija e ndërtimit duhet të identifikohet në zonë nga plani rregullues i qytetit ose vendbanimit (PPV).



Shembull i mirë i plotësimit duke ruajtur vijën e ndërtimit ekzistuese

Shembull negativ i plotësimit që nuk përputhet me vijën e ndërtimit ekzistuese përpara dhe atë anësore të oborrit.

- ORIENTIMI


Orientimi i një ndërtese është drejtimi me të cilin ajo përballet. Shumica e ndërtesave me vlera të trashëguara drejtohen drejt rrugës, me fasadën e tyre dhe me hyrjen kryesore në pamje të plotë. Por ka edhe raste kur ndërtesat e trashëguara janë të orientuara nga oborri. Një ndërtesë e re duhet të respektojë orientimin primar të fqinjëve të saj. Hyrja është shpesh një tipar i rëndësishëm i banesës, sidomos kur ajo shihet nga rruga. Në këto raste duhen bërë përpjekje që hyrja kryesore të mos fshihet prapa një volumi të madh, ose garazhi, por të krijohet një dizajn që të fton, pra të jetë tërheqës në sytë e vizitorëve për të inkurajuar përdorimin publik të rrugës.



Ndërtime të reja, apo rikonstruksione të banesave që janë të orientuara ndaj oborreve të tyre dhe i kthejnë shpinën rrugës kryesore dhe lumit.

- SHKALLA

Shkalla është madhësia relative e një ndërtese në lidhje me strukturat fqinje. Ajo është gjithashtu madhësia relative e elementeve të ndërtesës ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj ndërtesës në përgjithësi, siç janë dritaret, dyert, kornizat dhe veçori të tjera. Shumica e ndërtesave të trashëguara në ansamblet që kemi në shqyrtim, si banesa e dyqane, janë projektuar në shkallë njerëzore. Madje edhe ndërtimet sociale, si kisha, xhamia, apo dhe ndërtesat qeveritare janë ndërtime ku është përdorur një shkallë humane në vend të një shkalle monumentale. Shkalla e ndërtimit të një strukture të re në këto ansamble duhet të jetë në përputhje me shkallën e përgjithshme të ndërtesave fqinje të saj. Nëse do të shpresohet të ndërtohet një strukturë më e lartë, duhet të bëhen përpjekje për të vendosur pjesët më të larta të ndërtesës sa më larg rrugës, mbrapa volumeve me shkallë njerëzore, në mënyrë që volumet e larta të mos jenë të dukshme, ose të paktën të jenë sa më pak të dukshme për këmbësorët dhe gjithashtu nuk do të mund të hedhin hije të panevojshme.



Linja që përdoren për të përcaktuar dukshmërinë e volumit të lartë të plotësimit, kur ky bëhet në pjesën e pasme të një ndërtese, në se ky shihet nga rruga apo jo.



Ndërtim i ri ngjitur me një ndërtim të trashëguar që nuk respekton shkallën ekzistuese dhe atë të ansamblit në përgjithësi.

- PROPORCIONET

Proportionet janë marrëdhëniet e dimensioneve të elementëve të ndërtimit, si dritaret, dyert, daljet, hyrjet, ballkonet, me njëra-tjetrën dhe me lartësitë. Proportionet shpesh shprehen në raporte matematikore. Për shembull, shumë ndërtesa të trashëguara me arkitekturë të bazuar në tipe të hartuara fillimisht në qendra të zhvilluara kanë përdorur raporte matematikore për të përcaktuar madhësinë dhe pozicionin e elementeve të ndërtimit. Dizajni i një ndërtese të re duhet të respektojë, por jo domosdoshmërisht të kopjojë përmasat ekzistuese të ndërtesës prarendëse, apo të ndërtesave fqinje.



Ndërtime të reja në hyrje të Qendrës Historike të pasuksesëshme për t'u përshtatur kontekstit të ansamblit të trashëgohar, pasi u mungojnë proporcionet në volume, në shkallë, në daljet konsol dhe në dizajnimin e llozhave e ballkoneve, dritareve, si dhe të elementëve të shtuar siç është një shkallë e jashtëme krejtësisht jashtë kontekstit të ansamblit.



Ndërtim i ri në hyrje të Qendrës Historike që nuk respekton proporcionet humane të ansamblit tradicional.

- RITMI

Përsëritja e elementeve të fasadës, si dritaret, dyert dhe daljet konsol, si dhe i hapësirave midis tyre japin një ritëm të caktuar. Hapësirat mes banesave gjithashtu, lartësia e kulmeve, kornizat, baxhot dhe volume të tjera të dala mbi çati përcaktojnë ritmin e një rrugë. Nëse projektohet një ndërtesë e re në një rrugë me ndërtesa ekzistuese ajo duhet të respektojë ritmin e fqinjëve të saj dhe peisazhin e rrugës.




Ndërtim i ri në Qendrën Historike që nuk ruan ritmin e dritareve, dyerve të ndërtimeve përreth.



Ritëm ballkonesh i shtuar gjatë rikonstruksionit të këtyre banesave në Qendrën Historike, i cili nuk ekziston kurkund në ansamblin e trashëguar.

- MASA

Masa është forma dhe madhësia e përgjithshme e një ndërtese. Masa, apo volumi i një ndërtese kontribuon ndjeshëm në karakterin e një rruge, veçanërisht në zona kur banesat, apo dyqanet janë të rreshtuara njera pas tjetrës. Si rezultat, ndërtimi i ri duhet të respektojë masën e ndërtesave fqinje ekzistuese. Masa e dukshme e një strukture mund të ndryshohet gjithashtu përmes shfaqjes së baxhove, dritareve dhe daljeve të tjera mbi çati, si dhe projeksionet në fasada, si llozha, konsola, ballkone, portikë e xokola.



Shembull i pasuksesshëm i plotësimit për shkak të masave dhe lartësisë në mënyrë të konsiderueshme më të vogël në krahasim me ndërtesat e trashëguara ngjitur me të.




Ndërtim i ri në Qendrën Historike që nuk respekton linjën e ndërtimit dhe as volumin e arkitekturën e ndërtimeve përreth

- LARTËSITË

Lartësitë e mureve, kornizave, kulmeve, llozhave, oxhaqeve dhe daljeve mbi çati, të gjitha këto kontribuojnë në karakterin e një ndërtese dhe atë të ansamblit. Ndërtesat e reja duhet të projektohen duke respektuar lartësitë ekzistuese të ndërtesave fqinje me vlera të trashëguara, edhe pse ato nganjëherë nuk kanë nevojë që domosdoshmërisht të jenë pikërisht me të njëjtën lartësi. Në përgjithësi, edhe nëse një ndërtesë e re është qoftë edhe gjysmë-kati më e lartë ose më e ulët se ndërtesat ekzistuese që janë të gjitha me të njëjtën lartësi, ajo do të shfaqet jashtë kontekstit. Por ka edhe raste kur, një ndërtesë e re që shtohet në një rrugë me struktura me lartësi të ndryshme mund të jetë më shumë se një kat më e lartë ose më e ulët se sa fqinjët e saj dhe përsëri mund të jetë brenda kontekstit. Kjo bën të detyrueshme parimin që çdo rast për plotësim në një ansambël duhet të konsiderohet si rast unik dhe të shqyrtohet në përputhje me kontekstin e ansamblit. Në shumë raste sprapsja e kateve të sipërme në ndërtimet e reja, duke ruajtur lartësinë e ndërtimeve fqinje në fasadën kryesore, mund të jetë gjithashtu e dobishme për ta përshtatur ndërtimin e ri brenda kontekstit. Kështu ndërtimi i ri shfaqet me lartësi të ulur në pamjen kryesore.



Shembuj të padëshirueshëm të plotësimit me ndërtim. Ndërtimi i ri është dukshëm më i madh se ndërtesat e trashëguara ngjitur me të.



Shembuj të pasuksesëshëm të plotësimit për shkak të lartësisë në mënyrë të konsiderueshme më të madhe në krahasim me ndërtesat e trashëguara ngjitur me to.

- MATERIALET

Materialet tipike të një ansambli me vlera të trashëguara, të tilla si tulla, guri ose druri duhet të parashikohen për tu përdorur në projektimin e një ndërtimi të ri plotësues. Sa më shumë materiale apo teknika të ndryshme të jenë përdorur përdorur në atë zonë, aq më shumë liri do të ketë për të integruar larmi më të madhe materialesh. Madhësia, struktura, tekstura e sipërfaqes dhe karakteristika të tjera përcaktuese të materialeve të jashtme janë po aq të rëndësishme sa lloji i materialit në vetvete. Për shembull, një ndërtesë e re e ndërtuar me beton, apo që ka në përdorim tulla xhami, në një rrugë me ndërtesa të trashëguara ku janë përdorur tulla të zakonshme nuk do të ishte brenda kontekstit.



Ndërtim i ri në ansambël të trashëguar që përveç volumit të madh përdor edhe forma e materiale për dekorimin e ballkoneve jashtë kontekstit.



Ndërtime të reja të pasuksesëshme për të ruajtur kontekstin e ansamblit të trashëguar

- NGJYRAT

Materialet e ndërtimit të përdorura në një ndërtesë shpesh përcaktojnë skemën e saj të ngjyrave. Për shembull, tulla, guri, plloçat e gurit, druri, llaçi, luspat prej asfalti (të çatave), bakri, plumbi dhe materiale të tjera që zakonisht nuk janë të ngjyrosura i japin ngjyra një ndërtesë. Skema e ngjyrave të një ndërtesë të re duhet të plotësojë atë të ndërtesave përreth. Si rregull i përgjithshëm, nuk duhet të përdoren më shumë se tre ngjyra të ndryshme në një ndërtesë të re që ndërtohet brenda një ansambli tradicional.




Ngjyra jashtë kontekstit të ansamblit tradicional



Kur dy bashkë-pronarë nuk bien dakort për ngjyrën e banesës

- FORMA E ÇATISË

Forma e çatisë të një ndërtese të re duhet të respektojë atë të fqinjëve të saj. Për shembull, në një rrugë të përbërë nga banesa me çati katër-ujëse, këshillohet që një ndërtesë e re të ketë një çati të projektuar në mënyrë të ngjashme. Futja e një stili të ndryshëm të çatisë, si një çati e sheshtë, apo shumë e pjerrët, do të ndryshonte karakterin ekzistues e të formuar me kohë të rrugës.



Shembull i dobët i plotësimit për shkak të llojit të papërshtatshëm të çatisë dhe vendosjes së hapjeve të dritareve dhe derës



Forma çatish në Lin që janë jashtë kontekstit tradicional



Ndërtime të reja me volume dhe çati me forma të çuditëshme jashtë kontekstit të ansamblit të trashëguar në Lin.



Çati me forma që nuk respektojnë ato të ndërtesave të trashëguara të ansamblit në Pogradec



- DETAJET DHE ZBUKURIMET

Disa ndërtesa të trashëguara në rajonin e Pogradecit përmbajnë detaje dhe zbukurime të përpunuara, ndërsa të tjerat kanë dizajne relativisht të thjeshta. Një ndërtesë e re duhet të marrë parasysh sasinë, vendndodhjen dhe përpunimin e ornamentit arkitektonik që ekziston në ndërtesat fqinje. Detajet dhe zbukurimet ekzistuese mund të përdoren si bazë për ato që duhet të përdoren në një ndërtesë të re, por njëkohësisht ato nuk duhet të kopjohen saktësisht. Duhet të përdoret një interpretim bashkëkohor i detajeve historike dhe zbukurimit për të dalluar një ndërtesë të trashëgimisë dhe një ndërtim i ri që përpiket të jetë brenda kontekstit.



Dekorim jashtë kontekstit në Tushemisht

- KARAKTERISTIKAT E PEIZAZHIT

Bimët, pemët, gardhet, muret rrethues, trotualet, shtresat e rrugëve dhe karakteristika të tjera të peizazhit janë elementë të rëndësishëm që përcaktojnë karakterin e lagjeve historike. Nëse është e mundur, pemët, shkurret dhe peizazhi ekzistues duhet të mbahen kur ndërtohet një strukturë e re në një parcelë. Nëse kjo nuk është e mundur, duhet të hartohet e projektohet peizazhi që plotëson ndërtesën e re dhe strukturat fqinje. Ndërtimi i ri mund të ndryshojë modelet e drenazhimit të vendit apo truallit dhe këto të ndikojnë tek pemët që ndodhen brenda truallit dhe të tjerat pranë tij. Mbrojtja e pemëve kryesore me rrënjë të zhvilluara mund të kërkojë praninë e një specialisti gjatë ndërtimit. Duhet gjithashtu të ruhen karakteristika të rëndësishme ekzistuese të peizazhit, si gardhet, muret rrethues, apo rrethimet me kangjella hekuri. Përsëri, nëse kjo nuk është e mundur, duhet të ndërtohen veçori të reja që të përputhen me ndërtesën e re.

Kalldrëmet e rrugëve, kullimet e trotualet e tyre, lumi, apo përroi që kalon përmes, janë gjithashtu elementë të rëndësishëm të peizazhit në një ansambël të trashëguar. Ato duhet të ruajnë veçoritë e materialeve e teknikave të tyre, ndërsa ndërtimet e reja e rikonstruktionet nuk duhet të tjetërsojnë në asnjë rast karakterin e tyre të trashëguar.




Ndërtime të reja në Lin që nuk respektojnë karakterin e peisazhit tradicional në Lin.



Kalldrëm i ri jashtë kontekstit të ansamblit të trashëguar në Lin.

- NDËRTESAT NDIHMËSE

Ndërtesat ndihmëse, të tilla si garazhet dhe punishtet, janë një element i rëndësishëm që përcakton ruajtjen e kontekstit në ansamblët me vlera të trashëguara. Nganjëherë, nëse ansambli ka ndërtime të tilla ekzistuese, ato shtojnë interesin në shkallëzimin e volumeve dhe pamjeve për ndërtesat kryesore. Sigurisht, strukturat e reja të dizajnuara për tu përfshirë në ansamble të tilla duhet të marrin parasysh kontributin që ato i bëjnë karakterit të ansamblit dhe të rrugës ku ndërtohen. Ato duhet të respektojnë vendndodhjen, madhësinë dhe materialet e atyre ekzistuese.



Përfshirja e pahijshme e garazheve në kundërshtim me kontekstin e ndërtesave pranë.



Volum i një ndërtimi ndihmës i shtuar pa sukses në një monument kulture të kategorisë I-rë

- PARKINGU

Zhvillimet e reja dhe plotësimet nuk duhet të përkeqësojnë situatën e parkimit në ansambël, veçanërisht nëse ka raste kur ka mungesë të hapësirave të parkimit për banorët dhe vizitorët. Hapësira e parkimit duhet të shikohet, kontrollohet nga zona private e banimit (banesa), që të jetë e sigurt dhe e dukshme nga banesa.

KOMPOZIMI, PËRBËRJA E ANSAMBLIT

Ansamblët e formuara në rajonin e Pogradecit kanë karakter arkitektonik të dallueshëm që përcaktohen nga metodat dhe materialet e ndërtimit vendas dhe si dhe stili, apo tipologjia e periudhës në të cilën është ndërtuar ansambli. Kur ky karakter është i qëndrueshëm është e rëndësishme që zhvillimi i ri plotësues të reflektojë karakterin ekzistues sa më shumë që të jetë e mundur. Sidoqoftë, kur karakteri ekzistues është më i ndryshëm, si në ansamblët që zhvillohen gjatë periudhave më të gjata kohore, ose në ansamble me një përzierje të ndryshme të tipologjive të banesave dhe ndërtesave tregtare, ekziston më pak presion për t'u përshtatur, por gjithësesi karakteri duhet ruajtur.



Tjetërsimi i karakterit arkitektural të Qendrës Historike në lagjen e Burimeve në Pogradec. Dy foto të marra pothuajse nga i njëjti kënd por në kohë të ndryshme.

ELEMENTË TË TJERË URBANË PËR ANSAMBLIN



Planet për ndërtimin e plotësimit duhet të përqendrojnë të përfitojnë nga lehtësitë e elementëve urbanë, të tilla si parqet, shërbimet dhe transporti publik. Për shembull, ndërtimet e reja duhet të sigurojnë që një pamje e rëndësishme apo qasje në një park të lagjes nuk do të prishet ose të ndryshojë për banorët dhe vizitorët në zonë. Peizazhi ekzistues i vendit duhet të përdoret për të vazhduar ose për të kontribuar në gëzimin e parqeve publike dhe hapësirave të hapura. Më konkretisht, mund të inkorporohen dritaret anësore ose të gjata për të fituar pikëpamje të tipareve të rëndësishme topografike, ose ballkone të nivelit të lartë dhe tarraca të çatisë mund të përfshihen për të siguruar zona të jetesës private në natyrë dhe pamje pa pengesa.

SHEMBJET

Ruajtja dhe integrimi i ndërtesave të trashëgimisë në zhvillimin e ri inkurajohet dhe mund të kërkohet nga bashkia lokale. Një vlerësim i ripërdorimit potencial të ndërtesave në një vend që plotësohet duhet të ndërmerret para se të merret një vendim për prishjen e tyre. Kur mendohet të spostohet një ndërtesë historike për të lejuar dendësi më të madhe ndërtimi, duhet të merren parasysh lëvizja e ndërtesës në një vend të ri. Megjithatë, nëse kjo nuk është e mundur, duhet të ndërmerret një rikuperim i kujdesshëm i materialeve të rëndësishme ndërtimore historike për të lejuar përdorimin e tyre në restaurimin e ndërtesave të tjera.

PËRMBLEDHJE

Ndërtimi i një plotësimi të suksesshëm në ansamblet me vlera historike është një mënyrë efektive për të siguruar që konteksti dhe karakteri unik arkitektonik i ansamblit të ruhet me kalimin e kohës. Kjo bën të mundur që ansambli të evoluojë duke ruajtur dhe respektuar njëkohësisht edhe frymën e periudhës në të cilën është ndërtuar fillimisht. Për të siguruar që një projekt për një ndërtim plotësues të jetë i suksesshëm, duhet të ndiqet respekti ndaj parimeve të përshkuara më sipër. Konsultimi me një profesionist të trashëgimisë, apo edhe një institucion rajonal të trashëgimisë që ka staf të pregatitur sigurojnë gjithashtu që hartimi i një projekti të ri plotësues të jetë i respektueshëm ndaj kontekstin të ansamblit në të cilën do të qendrojë.

2.2 TIPOLOGJITË - TRASHËGIMIA E ARKITEKTURËS RESIDENCIALE

BANESAT NJË FAMILJARE

- Banesat njëfamiljare me një nivel - rurale
- Banesat njëfamiljare me një nivel - urbane
- Banesat një familjare me dy nivele - rurale me ballkone me konstruksion druri
- Banesat një familjare me dy nivele me zhvillim asimetric - rurale
- Banesat një familjare me dy nivele me zhvillim asimetric - urbane
- Banesat një familjare me dy nivele me zhvillim simetric - rurale
- Banesat një familjare me dy nivele me zhvillim simetric – urbane
- Banesat një familjare me tre nivele me zhvillim simetric - rurale
- Banesat një familjare me tre nivele me zhvillim simetric - urbane

BANESAT PËR DY APO MË SHUMË FAMILJE

- Banesat për dy apo më shumë familje me zhvillim të lirë - urbane
- Banesat për dy apo më shumë familje me zhvillim simetric - rurale
- Banesat për dy apo më shumë familje me zhvillim simetric - urbane
- Banesat komplekse, ansamble - rurale
- Banesa me përdorim të përzier - urbane
- Banesa me plitharë
- Banesa në terren të pjerrët
- Banesat me influencë perëndimore

TIPOLOGJITË

Hyrje (shpërndarje, kriteret etj.) Trashëgimia e arkitekturës residencale

TRASHËGIMIA E ARKITEKTURËS RESIDENCIALE

Kur flasim për trashëgimisë kulturore të një vendbanimi, apo rajoni, një nga aspektet më të rëndësishme të saj është trashëgimia ndërtimore, ku arkitektura e ndërtesave të banimit, apo siç quhet në literaturë *residencale*, ze vendin kryesor. Zhvillimi i arkitekturës tradicionale të banimit ka ecur përmes shekujve i ndikuar nga faktorë të ndryshëm natyrorë, socialë, ekonomikë, politikë, etj., duke sjellë në jo pak raste krijime të jashtëzakonshme dhe duke shpalosur shumëllojshmëri stilesh, formash e dekorimesh. Në mënyrë të veçantë kur kjo arkitekturë tradicionale banimi është pjesë e zonave urbane, ajo ndikon në mënyrë të ndjeshme në planifikimin urban të qendrave të banimit dhe në ruajtjen, apo kompletimin e konturit të tyre historik. Prandaj njohja, studimi, mbrojtja dhe ruajtja e kësaj pjese të trashëgimisë ndërtimore merr një rëndësi të jashtëzakonshme, duke na dhënë njëkohësisht përgjegjësinë për tua përcjellë edhe brezave që do të vijnë më pas.

Tipologjia në arkitekturën e banesave tradicionale është klasifikimi i karakteristikave individuale që gjenden në banesat e vendbanimeve, sipas lidhjes që ato kanë me kategori dhe aspekte të ndryshme, duke formuar modele, ose tipe. Në Ballkan në përgjithësi ka qënë mjaft i përhapur një tip i dallueshëm banese, të cilin disa studiues e kanë quajtur *banesa ballkanike*, disa të tjerë *banesa maqedonase*, e disa *banesa turke*. Sot kryhen shumë diskutime e debate në se ky tip përgjithsues i banesës ballkanike ka qënë vendas, apo u huazua nga banesa turke e fshatrave të Anadollit. Fatkeqësisht ne nuk kemi shembuj arkitekturalë të periudhanve para tre, katër apo pesë shekujsh, pasi e gjithë veprimtaria ndërtimore që ne trashëgojmë sot, duke e konsideruar atë si tradicionale, na vjen kryesisht nga shekulli 19, apo fillimi i shekullit 20, dhe rrallë nga shekulli 18, pra, nga një periudhë në të cilën i gjithë ky rajon ishte nën sundimin e Perandorisë Otomane. Ndaj dhe nuk mund të thuhet me siguri në se ky tip erdhi nga Anadoli, apo Anadoli e huazoi atë nga Ballkani mbasi otomanët e pushtuan atë në shekullin 15.

Por, pamvarësisht nga këto debate e hamëndësime, shumë faktorë estetikë, tradicionalë ose jo, lokalë apo qendrorë, të lidhura këto edhe me perceptimet, konceptet krijuese dhe aftësitë të mjeshtërve të ndërtimit, na bëjnë të mendojmë se në këta dy shekuj, 18 dhe 19, arkitektura tradicionale e banimit ka arritur kulmore të saj. Në këtë kuadër nuk mund të bëjnë përjashtim as vendbanimet në pellgun e liqenit të Ohrit, të cilat, duke u ndodhur pak a shumë në zemër të Ballkanit dhe përgjatë rrugës Egnatia, e cila ishte si një lloj autostrade për lidhjen krahinave perëndimore të tij me kryeqytetin dhe ku qarkullonin idetë, teknikat, mjeshtëritë dhe konceptet më të përparuara të kohës, kishin prioritetin në thithjen dhe implementimin e tyre. Vetë qyteti i Ohrit, sikurse dhe Berati pak më në perëndim të kësaj 'autostrade', përfaqëson një nga shembujt më të shkëlqyer të arritjeve në zhvillimin e arkitekturës residenciale, duke rrezatuar modele, teknika dhe shije estetike në të gjitha vendbanimet përreth. Pikërisht është ky rrezatim që ne e shohim të reflektuar ku më shumë e ku më pak në të gjithë karakterin e vendbanimeve përreth liqenit të Ohrit, madje edhe në brendësi të krahinave rrotull tij, duke i dhënë një nuancë lokale lehtësisht të dallueshme kësaj trashëgimie.

Pra, kur flasim për tipologjinë e banesave ajo duhet parë në kuadër të të gjithë rajonit dhe jo e ndarë nga kufijtë e sotëm.

Tipologjia e ndërtimeve të trashëguara në vendbanimet në shqyrtim mund të përcaktohet në bazë të zhvillimeve të tyre planimetrike e volumore dhe atyre që lidhen me faktorë të ndryshëm si:

- Funkzioni për të cilin është kryer ndërtimi
- Tiparet e terrenit ku është kryer ndërtimi
- Teknikat e përdorura në ndërtim
- Influenat e ndërtimeve të huaja në periudha të ndryshme

Megjithëse ka studime të shumta mbi arkitekturën tradicionale residenciale në Shqipëri, në përgjithësi dhe në veçanti, (Berati, Gjirokastra, Kruja, Shkodra, Korça) përsëri vihet re një mungesë e theksuar në njohjen e arkitekturës së banimit të zonës së Pogradecit dhe fshatrave rreth tij. Disi më ndryshe qëndron situata në anën tjetër të kufirit në lidhje me banesën residenciale të qytetit të Ohrit dhe të disa vendbanimeve pranë tij, duke përfshirë edhe rajonin përreth liqeneve të Prespës së Madhe dhe asaj të Vogël. Plotësimi i këtij boshllëku në njohjen e arkitekturës residenciale në pjesën shqiptare të Liqenit të Ohrit kërkon padyshim studime të hollësishme rreth tipologjive ekzistuese që kanë ekzistuar dhe që ruhen ende në arkitekturën tradicionale të banesave në këtë pellg.

Studime dhe hulumtime të tilla, që për fat të keq duhet të ishin ndërmarrë shumë më herët, do të duhet të balafaqohen me një numër problemesh serioze, kryesisht lidhur me autenticitetin dhe sidomos me transformimin. Transformimi i ngadalshëm (që rezulton në rritjen dhe ndryshimin e vendbanimeve) që ka të bëjë me kohën dhe historinë "shtresëzimin historik" të qytetit është padyshim një proces i natyrshëm dhe shpesh rezulton me shtesa dhe ndryshime me kalimin e kohës në mënyrë që të akomodojnë nevojat e njerëzve.

Pogradeci ka përjetuar transformime të jashtëzakonshme në "tipologjinë" e arkitekturës së banesave. Transformimet më drastike ndodhën menjëherë pas vitit 1997, veçanërisht në lagjet e vjetra dhe ato buzë liqenit. Ndryshime

të tjera drastike (transformimi i pjesshëm ose total) i “dizajnit origjinal të banesave” ishin rezultat i nevojës për tu akomoduar me kërkesat e reja të jetesës. E gjithë kjo rezultoi në shkatërrimin e morfologjisë tradicionale arkitektonike, të siluetës dhe peisazhit karakteristik të rrugëve të përcaktuar ndër të tjera nga volumet e proporcionuara të banesave tradicionale.

Tipologjitë e paraqitura më poshtë nuk janë aspak rezultat i një studimi gjithëpërfshirës sistematik, por një studim i shpejtë mbi shembujt ekzistues të dhjetëra shtëpive që janë vizituar nga ekipi. Studimi merret kryesisht me formën, konceptimin e planit, por jo përkatësinë klasore apo shtresëzimin shoqëror. Është e domosdoshme të thuhet se elementi i përbashkët midis këtyre ndërtesave është mënyra se si janë ndërtuar. Të gjitha ato përbëhen nga mure guri dhe dysheme, apo tavane druri që mbulojnë hapësirën në mes. Ka prej tyre që muret e jashtme i kanë me gurë të prerë mirë, ndërsa të tjera me cilësi më të dobët ose me gurë kave. Ajo që e bën një ndërtesë ose një banesë më të rëndësishme se një tjetër është cilësia e punimit të gurit, drurit, suvasë dhe detajeve të përdorura në fasadë e në brendësinë e saj; portat, kolonat, trarët, dyshemetë, kapitelet, shkallët, tavanet, strehët, dritaret, mbishkrimet, etj. Këto janë tregues të rëndësishëm të nivelit shoqëror ose gjendjes ekonomike të një banese.

Sipas funksionit banesat tradicionale në të tri këto vendbanime kemi mundur ti ndajmë në:

1. **Banesat një familjare;** këto janë banesat më të përhapura dhe gjenden kudo, në zonat rurale dhe ato urbane, me karakteristikat e tyre dalluese. Ato mund të ndahen në: **banesa të thjeshta, me një nivel dhe në banesa një familjare me dy nivele.** Këtu duhet të kemi parasysh se llojet e banesave që gjenden në qendrat urbane dallojnë shumë nga ato të vendbanimeve rurale, jo vetëm në zhvillimin e tyre në kohë, por edhe në strukturën e tyre themelore. Zhvillimi i llojeve urbane është paralel ose më vonë se ai i llojeve rurale, ndërkohë që nuk është gjithmonë linear dhe mund të jetë edhe më i ndërlikuar. Kështu, tek banesat njëfamiljare me dy nivele dallohet një grup banesash të vjetra me ballkone me konstruksione druri, të ngjashme me banesat me *çardak*. Bazuar në format planimetrike të këtyre banesave janë veçuar gjithashtu në grupe **banesat me plane asimetrik dhe simetrik**, dhe në bazë të vendndodhjes dhe dallimeve që kanë ato grupohen në **rurale** dhe **urbane**. Një grup tjetër banesash janë ato të ndërtuara **në terren të pjerrët**.
2. **Banesat shumë familjare,** që u shërbejnë dy apo më shumë kurorëve brenda së njejtës familje, janë grupuar në **banesa me zhvillim të lirë**, sipas rrugës, **banesa me zhvillim simetrik me dy nivele** dhe **banesa me zhvillim simetrik me tre nivele** ku ka dallime ndërmjet tipeve që ndërtohen në zona rurale dhe atyre që ndërtohen në zonat urbane,
3. Një grupim i tretë është për ndërtimet e konceptuara si një ansambël, apo **banesa komplekse**, ku pranë banesës së familjes ndërtohen edhe mjediset ekonomike, plevicat, stallat, punishtet, dyqanet, etj. Ky grup ndahet në dy kategori kryesore: në fshat dhe qytet. Në fshat vërehen të jenë në tre kategori: kur ndërtimet ekonomike vendosen pranë banesës së fam iljes, kur vendosen përtej rrugës dhe kur vendosen larg, apo të distancuara nga banesa e familjes.

Ndërsa në qytet grupi i banesave me përdorim të përzier dallohet në dy kategori sipas teknikave, materialeve dhe periudhës së ndërtimit: banesat me dyqan, ose punishte me konstruksion druri dhe banesat me dyqan, ose punishte me konstruksion tulle.
4. Po sipas teknikës dhe materialeve të ndërtimit një grupim i veçantë është bërë për ndërtimet me plitharë, apo qerpiç, si një nga traditat më me interes në fushën ndërtimore
5. Grupimi i fundit bëhet për banesat me influenca të theksuara perëndimore, modelet e të cilave kanë ardhur nga Italia, kryesisht, gjatë viteve 1930' e që kanë vazhduar për inerci edhe në dekadën e parë mbas Luftës së II Botërore.

2.2.1 BANESAT NJË FAMILJARE

Në arkitekturën tradicionale të banimit këto janë banesa më të përhapura dhe të destinuara për jetesën e një familjeje. Këto banesa mund të ndahen në dy kategori kryesore, lehtësisht të dallueshme në trajtimin e tyre volumor:



1. Banesa njëfamiljare me një nivel
2. Banesa njëfamiljare me dy nivele
3. Banesa njëfamiljare me tre nivele

BANESAT NJËFAMILJARE ME NJË NIVEL

Në këtë grup hyjnë banesat e thjeshta, pa pretendime të forta arkitekturale, të cilat kanë si funksion primar atë utilitar për një familje me ekonomi modeste. Këtë tip banese e gjejmë mjaft të përhapur si në zonat rurale po ashtu edhe në ato urbane. Planimetria e tyre është e thjeshtë, pa ndërlikime dhe e përshtatur të plotësojë nevojat me minimale të jetesës. Volumi i tyre përgjithësisht është i ulët, pasi ngritja në lartësi është e lidhur me rritjen e kostos për ndërtimin e mureve. Shpesh muret e këtyre banesave janë të ndërtuara me plitharë të lidhur me llaç balte dhe të përforcuar me breza horizontale druri. Por nuk janë të pakta rastet kur ato ndërtohen mure me gurë, ku nuk mungojnë brezat horizontalë prej druri. Në këto raste gurët janë shumë pak të përpunuar, duke treguar qartë ekonomizimin e ndërtimit të tyre. Megjithëse shumë nga këto banesa dalin me njërën faqe në rrugë shpesh këto faqe nga rruga janë të verbëra, pa hapje, pa dritare, apo dyer. Strehët e çative nuk janë të gjera, ato nuk i kalojnë 30-40 cm, por shpesh bishtat e tyre janë të gdhendura me forma të lehta.

- FSHAT





- QYTET

Tipi i banesave me një nivel në zonën urbane të qytetit të Pogradecit, ndonëse nuk ka përhapje shumë të madhe karakterizohet nga planimetria e thjeshtë, hyrja me korridor të vogël me një apo dy dhoma anash, dhe volumi i ulët. Muret e këtyre banesave variojnë nga ato me plitharë, me gurë çrregullt e deri tek ato me gurë të rregullt, por gjithnjë me praninë e domosdoshme të brezave horizontale prej druri. Muret janë përgjithësisht të ulta dhe disi më të lehtësura se i njëjti tip në zonat rurale, duke bërë dallim prej tyre për shkak të përmasave pak më të mëdha të dritareve. Në pjesën e sipërme muret mbyllen, në ndërtimet më të hershme me strehën e ngushtë të çatisë, ku bishtat janë të zbuluar dhe lehtësisht të dekoruar, ndërsa në ndërtimet më të vona me kornizën e profiluar me suva.



BANESAT NJËFAMILJARE ME DY NIVELE

Banesat njëfamiljare me dy nivele i gjejmë mjaft të përhapura si në zonat rurale ashtu edhe në ato urbane. Duke qënë se tiparet arkitekturale të tyre dallojnë do të mundohemi ti trajtojmë veças.

Banesat një familjare me dy nivele i gjejmë në disa nën-grupime:

- Banesat një familjare me dy nivele në zonat rurale me ballkone me konstruksion druri
- Banesat një familjare me dy nivele me zhvillim asimetrik – rurale
- Banesat një familjare me dy nivele me zhvillim asimetrik – urbane
- Banesat një familjare me dy nivele me zhvillim simetrik – rurale
- Banesat një familjare me dy nivele me zhvillim simetrik - urbane

- BANESAT NJË FAMILJARE ME DY NIVELE RURALE DHE ME BALLKONE ME KONSTRUKSION DRURI

Banesat njëfamiljare rurale me dy nivele më të vjetra ndodhen në fshatin Lin. Ato dallohen për përdorimin e ballkoneve me konstruksion druri mjaft të ngjashme me banesat me çardak, sa mund të thuhet se këto lloj ballkonesh janë remineshenca të çardakëve të dikurshëm. Dikur, në shekujt 18– 19, tipi i banesave më çardak ka qënë tipi mbizotërues i banesave në të gjithë rajonin e Ballkanit. Në literaturë ky tip njihet më shpesh si *banesa maqedonase*, pasi ishte tipi i parapëlqyer në territoret e Maqedonisë së dikurshme antike (Greqia veriore, FYROM). Në territoret e Shqipërisë ato gjenden më së shumti në Berat dhe më rrallë në Krujë, Lezhë e Korçë.

Elementi kryesor që i dallon banesat e këtij tipi, nga ku ka marrë edhe emrin, është *çardak-u*, një pjesë e hapur në formë verande, apo ballkoni, e cila luan një rol kryesor në kompozimin planimetrik dhe volumor të ndërtesës. Kjo hapësirë shfrytëzohej së tepërmi nga banorët gjatë stinës së ngrohtë, duke shfrytëzuar në maksimum dritën natyrale dhe ajrin e freskët. Çardak-u ndërtohej në ballë të dhomave të banimit dhe shërbente edhe si ambient ndërlidhës për to. Ai drejtohej nga jugu, ose perëndimi, për të mos u rrahur nga erërat. Konstruksioni i tij ishte tërësisht me elementë druri (kolona, kapitete, trarë, parmakë, shkallë, dysheme, etj.) të cilët përpunoheshin dhe shpesh dekoroheshin artistikisht. Çardak-u ishte element formues kryesor në pamjen e banesës, ndërsa vendosja e tij në raport me dhomat përcaktonte variantin, apo llojin e banesës; si p.sh. *“banesë me çardak në të gjithë ballin”*, *“me çardak në një krah”*, *“me çardak në qendër”*, *“në formë L”* etj.

Me kalimin e kohës sipërfaqja e çardak-ut u zvogëlua, sidomos në vendet me klimë të ftohtë, duke shërbyer më tepër si vend-kalimi (një lloj korridori i hapur) për në dhomat e banesës. Pikërisht në këtë fazë të zvogëlimit të madhësisë së tij dhe të ndryshimit të funksionit të tij e gjejmë edhe në banesat e vjetra të fshatit Lini. Banesat më të vjetra kanë ballkone me konstruksione druri, të ndërtuara duke u bazuar në teknikat dhe elementët e çardak-ut. Këto ballkone nuk kanë madhësinë dhe funksionin e verandës së madhe. Në banesat me çardak ngjitja në të bëhet përgjithësisht nga jashtë, me shkallë druri, ndërsa në banesat e Linit dalja në ballkonin prej druri realizohet vetëm nga mjediset e katit të sipërm, kryesisht nga korridori kryesor, që zakonisht është i mbyllur. Gjithashtu volume i ballkonit, duke mos qënë shumë i dalë nga muratura vertikale, mbështetet mbi trarët e dyshemesë së ndërkatit që dalin jashtë muraturës. Këta trarë dalin konsol, por në shumë raste mbështeten edhe mbi kolona druri vertikale në tokë, në katin pëdhe, duke krijuar një hapësirë nën ballkonin prej druri, që quhet *hajat* (turq.). Ky është i njëjti emërtim që përdoret edhe për hapësirën e katit përdhe në banesat me çardak. Si rregull e gjithë hapësira e ballkoneve me konstruksione druri mbulohet në pjesën e sipërme me çati me strehë e gjerë, e cila zakonisht mbështetet mbi kolona druri vertikale, të vendosura me distancë të caktuar njera nga tjetra dhe që shkarkojnë mbi trarët e ndërkatit dhe këta mbështeten mbi kolonat e hayat-it, ose dalin konsol.

Midis kolonave vertikale të ballkonit, në dy nivele në pjesën e poshtëme (dysHEME dhe pak më lart) vihen horizontalisht elementë druri (kadrona) ku mbërthehen parmakët e ballkonit. Zakonisht tek banesat me çardak, si në Berat, Krujë, Korçë, apo edhe Kastoria, Veria, etj., parmakët i gjejmë rëndom të ndërtuara me listela druri, ndërsa në rajonet e Ohrid e të Prespës, sikurse edhe në Lin, parmakët e ballkoneve janë të formuara nga pllakoma dërrasash të vendosura vertikalisht e të mbërthyer tek elementët horizontalë (kadronat) midis kolonave. Ky është një element karakteristik i kësaj zone, që e dallon lehtësisht këtë variant banese nga të tjerët e këtij lloji në Ballkan.

Fatmirësisht në fshatin Lin ruhen ende disa shembuj të banesave me ballkone me konstruksion druri, nga ato më të thjeshtat e deri tek ato më të zhvilluarat, çka tregon se larmia e tyre ka qënë e shumëllojëshme dhe preferenca e padiskutueshme. Këta shembuj, ndonëse nuk janë të plotë, por të gjysmuar e të transformuar, na lejojnë të rikrijmë format origjinale të tyre, në mënyrë që të gjykojmë mbi vlerat që kemi pasur, ato që kemi humbur dhe që duhet të ruanim më mirë nga e kaluara.

Të gjitha këto banesa janë me dy nivele (kate), ku kati përdhe i përshtatej më tepër funksioneve dhe aktiviteteve të ditës, ndërsa kati i sipërm kishte kryesisht funksionet e shlodhjes dhe fjetjes. Muret e këtyre banesave janë të ndërtuara kryesisht me gurë në të gjithë lartësinë e tyre, në të dy nivelet. Gurët lidhen me llaç balte dhe në lartësi të caktuara ndërtohen lidhje të veçanta me breza horizontalë druri. Qoshet e mureve ndërtohen me gurë më të mëdhenj, të cilët përpunohen më me imtësi se sa gurët e tjerë. Ato skuadrohen në blloqe të rregullta, me faqe katërkëndore dhe kur vendosen njeri mbi tjetrin, gjatësitë e tyre alternohen në të dy faqet e mureve që lidhen.



BANESA 1



Banesa 1 është ndërtuar në degëzimin e dy rrugëve dhe ka hyrje nga të dyja. Banesa ka formë ortogonale, duke i treguar rrugës kryesore (nga perëndimi) faqen më të ngushtë të saj. Faqja veriore ndjek linjën e rrugës që shkon përgjatë bregut të liqenit, ndërsa ajo jugore përfiton edhe një hapësirë trekëndore përpara saj.


Banesa është me dy nivele dhe e ndërtuar tërësisht me mure guri. Në katin përdhe ndodhen mjedise shërbimi, ndërsa në aktin e sipërm ndodheshin dhomat e fjetjes. Hapësirat e dritareve në të dy katet kanë përmasa relativisht të vogla dhe megjithëse janë të shumta pamjet veriore e perëndimore i mbizotëron masa e madhe e murit të gurit. Në faqen jugore është ndërtuar një hyrje për në katin e sipërm me shkallë të jashtme guri, sheshpushimi i të cilave mbulohet nga një portik me kolona të thjeshta druri, të skuadruara, që mbajnë një strehë çatie të ndërtuar në mënyrë të dyfishtë.

Në faqen lindore të banesës, thuajse në të gjithë gjatësinë e saj, është ndërtuar një ballkon, i cili mbështetet me kolona druri vertikale në katin përdhe, duke i dhënë pamjen e një çardak-u të hapur. Sot ruhet vetëm një pjesë e tij, pasi banesa ka pësuar transformime. Megjithatë nga aq sa ka mbetur mund të gjykohej se kolonat vertikale prej druri, që mbajnë ballkonin dhe çatinë mbi të, vendosen njëra mbi tjetrën. Ato kanë kapitele të thjeshta druri, herë të punuar e herë jo, ndërsa strehët janë dyfishe, të ngjashme me ato të banesave me çardak. Parmakët përbëjnë një element tepër dallues të këtij tipi në këtë rajon. Ato nuk janë me kadrone, siç i gjejmë në ballkonet, apo banesat me çardak të rajoneve të tjera, por me dërrasa të ngushta, të vendosura shumë pranë njëra tjetrës, duke i dhënë një pamje gjysëm të mbyllur ballkonit. Ky element shoqëron thuajse të gjitha banesat e vjetra me ballkone druri në rajonin përreth liqenit të Ohrit dhe atë të Prespës, duke i dhënë asaj një tipar të dallueshëm lokal.



Banesa me ballkone me konstruksion druri

BANESA 2



Gjendja ekzistuese



Pamja fillestare

Banesa 2 ka qënë një banesë më e madhe dikur. Sot ruhet vetëm 1/3 e saj pasi pjesa tjetër është prishur për ti lënë vendin një ndërtimi të ri. Megjithatë nga atë që ka mbetur mund të gjykojmë vetëm pjesërisht mbi planin, funksionin dhe arkitekturën e saj. Banesa është me dy nivele, e vendosur në një terren të pjerrët dhe e ndërtuar krejtësisht me mure guri. Planimetria e banesës duhet të ketë qënë e tipit me korridor qendror dhe me mjediset e banimit anash tij. Kjo duhet të ketë qënë reflektuar edhe në pamjen kryesore nga veriu ku elementi qendror duket se ka qënë ballkoni prej druri në formë çardaku, si një zgjatim i korridorit qendror mbi hyrjen kryesore, ndërsa anash tij qendrojnë simetrikisht nga dy dritare të vogla për çdo dhomë në të dy katet, siç duket edhe në pjesën e mbetur.

Në faqen perëndimore, e cila përshkallëzohet nga pjerrësia e terrenit, ka një hyrje në katin e sipërm me disa shkallë guri. Por zgjatimi i sheshpushimit me konstruksion druri në të gjithë faqen perëndimore ka krijuar një ballkon të ngushtë, të ngjashëm me një çardak të vogël, të mbuluar me një çati me strehë dyfishe. Kolonat prej druri janë të skuadruara dhe mes tyre janë vendosur parmakët me dërrasa të afruara, që përbëjnë edhe tiparin dallues të ballkoneve me konstruksion druri në këtë rajon.

Rast i veçantë

BANESA 3



Banesa 3 është një banesë me përmasa të mëdha dhe përfaqëson ndoshta variantin më të zhvilluar të banesës me ballkone me konstruksion druri të hasur në të gjithë bregun shqiptar të liqenit të Ohrit. Sot banesa paraqitet me një sërë ndryshimesh e transformimesh pa kriter, por gjurmët e elementëve arkitektonikë na lejojnë të lexojmë dhe të krijojmë idenë e funksionit dhe pamjes fillestare të saj.



E vendosur në një terren të pjerrët banesa del me tre kate në pamjen kryesore që sheh nga veriu. Qysh në fillim banesa ka qënë e destinuar ti shërbejë familjeve të tre vëllezërve, duke mundësuar tre hyrje në pamjen kryesore dhe zhvillim në verticalitet për secilën familje, nëpërmjet shkallëve të brendëshme. Pamvarësisht nga funksioni për tri familje banesa ruan një trajtim arkitektural unifikues në trajtimin e fasadës kryesore, me karakter thuajse simetrik, duke krijuar përshtypjen se kemi të bëjmë me një banesë të madhe për një familje. Forca e traditës ndërtimore i ka dhënë zhvillim ndërtimit të ballkoneve me konstruksione druri në secilin nga katet e mësipërme, të cilët shtrihen përgjatë gjithë fasadës, duke krijuar kështu një pamje me plasticitet krejt të veçantë dhe deri diku impresionues. Ballkonet me konstruksione druri në të dy katet mbështeten mbi trarë të fuqishëm që dalin nga ndërkatet në formë konsoli. Dalja e madhe tyre, rreth 1,5 m, na bën të besojmë se në kokat e tyre mund të ketë pasur mbështetje të tjera horizontale dhe vertikale në të të tre katet. Kjo arkitekturë me dy nivele ballkonesh me konstruksione druri, të projektuara jashtë muraturës së gurit, me kontraste të theksuara nga loja e dritë-hijeve të volumeve, e teksturës së materialeve gur-dru, e ngjyrave të tyre dhe të gjitha këto përpara një shkëmbi që ngrihet vertikalisht përpjetë, kanë pasur një pamje vërtet mbresëlënëse në kohën saj. Ky zhvillim i fuqishëm me tre kate dhe me ballkoneve me konstruksione prej druri në dy nivelet e sipërme gjatë gjithë fasadës, e rendit këtë banesë si banesën më të zhvilluar këtij lloji të hasur deri më sot në të gjithë pellgun ujëmbledhës të Liqenit të Ohrit.



BANESAT NJË FAMILJARE ME DY NIVELE ASIMETRIKE

Këto banesa janë ndërtime tradicionale tërësisht apo pjesërisht me muraturë guri, e cila ndërpritet në lartësi të rregullta nga breza druri horizontale. Këto banesa kanë planimetri të shumëllojshme me hyrje anësore, apo edhe disa hyrje në katin përdhe. Format e tyre volumore janë përgjithësisht solide e kompakte, pa hapje të shumta e të ndjeshme. Katet përdhe karakterizohen nga dera kryesore, që përgjithësisht është e ulët, dhe një minimum dritaresh me përmasa të vogla. Katet e sipërme kanë gjithashtu lartësi jo të madhe, dritare mesatare, tipike për përdorimin e tyre në mure guri. Madje edhe kur përdoren muret e lehta (çatma) përmasat e dritareve janë të kursyera. Muret e lehta (çatma) në katet e sipërme i gjejmë shpesh të ndërtuara jo vetëm kur ato kanë ndonjë dalje konsol nga muret e gurit të katit përdhe, por edhe kur ato ndërtohen duke u mbështetur mbi to. Në rastet kur volumet e katit të sipërm dalin konsol kjo lëvizje bëhet kryesisht në fasadën kryesore, çka tregon për forcën e traditës në trajtimin e tipareve arkitekturale. Daljet konsol të kateve të sipërme janë të vogla dhe realizohen me trarët e ndërkatit. Kokat e këtyre trarëve në me të shumtat e rasteve nuk dekorohen megjithëse lihen në dukje. Muret e lehta (çatma) pasi ndërtohen, suvatohen mbi to dhe kornizohen në anët e tyre me fashatura druri. Në pjesën e sipërme ato mbyllen me strehën e çatisë, trarët, apo bishtat e të cilës lihen gjithashtu zbuluar.

Banesat një familjare me dy nivele asimetrike - Rurale





BANESA 1 TUSHEMISHT


Sot ruhet vetëm gjysma a banesës së dikurshme, pasi gjysma tjetër është prishur për ti lënë vendin një ndërtimi të ri. Nga ajo çka ka mbetur mund të gjykohej se banesa kishte hyrje drejtpërdrejt nga rruga në katin përdhe me lartësi të ulët e të ndërtuar rrejtësisht me mure guri. Përveç korridorit dhe disa mjediseve ndihmëse këtu ndodhej edhe dhoma e dimrit, apo e zjarrit e pajisur me vatër. Ndriçimi i mjediseve të katit përdhe ishte i pakët, me dritare të vogla, që mbylleshin me kanata druri. Muratura ishte me gurë të çrregullt të lidhur në lartësi me breza druri, çdo 80 cm. Shkallë të ngushta druri të çojnë në katin e sipërm, ku ndodhen mjediset e fjetjes. Edhe ky kat ka lartësi të ulët, sikurse kati përdhe, por ndryshon prej tij përsa i përket ndriçimit. Dritaret e këtij kati janë relativisht më të mëdha dhe kanë kanata druri me rrëshqitje vertikale. Muri i katit të sipërm që sheh nga rruga (pamja kryesore) del me një konsol të lehtë jashtë murit të katit përdhe. Kjo është realizuar nga trarët e ndërkatit, të cilët dalin rreth 40 cm jashtë murit të gurit të katit përdhe. Mbi kokat e tyre të papërpunuara është vendosur një tra druri horizontal dhe mbi të ngrihen vertikalisht kolona druri në distanca të çrregullta nga njera tjetra dhe të lidhura horizontalisht me kadrone druri. Në hapësirat midis tyre janë vendosur dritaret, të cilat gjithashtu nuk ruajnë të njëjtën distancë nga njera tjetra. Mbushja e këtij konstruksioni çatmaje është bërë me tulla dore të punishteve të hershme, të cilat kanë zëvendësuar tullat prej plithari që ka pasur ai dikur. Shembuj të tullave



prej plithari mund shihen ende në qoshet dhe disa pjesë të palëvizura të konstruksionit, çka tregon se mbushja e çatmasë ka qënë fillimisht me tulla plithari dhe më vonë është zëvendësuar me tulla dore. Por duke gjykuar nga forma, përmasat dhe përbërja e tyre dallohet se këto janë prodhime të punishteve të hershme, pa filluar ende prodhimi i tullave gjysëm-industriale me mjete dhe receptura që u sollën nga Italia në vitet 1920-1930. Si përfundim mund të pranohet se banesa i përket shekullit 19 dhe ka pasur një rikonstruksion në vitet 1910-1920.

BANESA 2 TUSHEMISHT





Kjo banesë është ndërtuar në pjesën më të vjetër të vendbanimit Tushemisht, pranë kishës, në një terren të pjerrët. Është ndërtuar nga një familje në gjendje të mirë ekonomike dhe me prirje intelektuale. Hyrja në banesë bëhet drejt-përdrejt nga rruga në anën jugore të saj. Korridori nuk është qendror, por ndodhet në njërin krah dhe në krahun tjetër rreshtohen mjediset e dimrit, duke u renditur në skemën planimetrike të banesës me korridor anësor. Në këtë korridor anësor ndodhen edhe shkallët që të çojnë në nivelin, apo katin e dytë, ku është zbatuar e njëjta skemë planimetrike.

Dritaret e katit përdhe me mur guri kanë dimensione të kursyera, në formë kuadratoke, ndërsa ato të kaatit të sipërm janë të mëdha, duke ndriçuar bollshëm mjediset e këtij kati.

Banesa nuk ka ballkon, as çardak, por dallohet nga përdorimi i konstruksionit të lehtë me çatma në të gjitha muret e katit të sipërm. Për të gjitha përforcimet këndore, në të katër këndet e këtij kati janë përdorur përforcime digonale sipas trekëndëshave.

Mbushjet e hapësirave të murit me konstruksion druri janë me tulla dore të lidhura me llaç balte. Ndërsa suvatimi i jashtëm i gjithë këtyre mureve në katin e sipërm është me llaç gëlqere. Në të katër qoshet e katit të sipërm janë vendosur fashatura druri vertikalisht, të cilat veshin kolonat vertikale të qosheve. Shenjat tregojnë se edhe dritaret kanë pasur në pjesën e jashtëme fashatura druri përreth tyre.

Strehët, megjithëse jo të gjera, janë formuar nga kokat e trarëve të tavanit, të cilat janë dekoruar lehtë në fundet e tyre. Me interes shihen lidhjet e trarëve horizontalë në katër qoshet nën strehë, të cilët janë lidhur mjeshtërisht me kllapa ekzakte, duke siguruar një lidhje të qëndrueshme të të gjithë konstruksionit prej druri të mureve të aktit të sipërm.

Në shumë prej kokave të trarëve të strehës shihen vrima të hapura enkas për ndonjë funksion ende të panjohur për ne sot.

Muret e gurit në katin përdhe janë fugatuar gjithashtu me llaç gëlqere, duke lënë në dukje brezat horizontalë prej druri.

BANESA 4 TUSHEMISHT

Megjithëse ndërtimi i kësaj banese i takon një periudhe më të vonë, ai ruan ruan thuajse të njejtën skemë planimetrike me korridor anësor, sikurse banesa e mësipërme. Kati përdhe është me mure guri me qoshe të rregullta dhe me breza druri. Muri i gurit vazhdon edhe në një pjesë të mureve të katit të sipërm,. Ndërsa pjesa tjetër e tyre është ndërtuar me konstruksion të lehtë druri (çatma) dhe të mbushur me tulla të lidhura me llaç gëlqere. Kolonat vertikale të skeletit të drurit të çatmasë ndjekin ritmin e dritareve, ndërsa kolonat e qosheve janë vendosur mbështetje (lidhje) diagonale.. Strehët janë lënë të hapura, ku dallohen trarët e tavanit të katit të sipërm. Të cilët dalin në formë bishtash.



Banesat një familjare me dy nivele asimetrike - Urbane


Banesat një familjare me dy nivele me zhvillim planimetrik asimetrik në qytetin e Pogradecit ruajnë pak a shumë të njejtin karakter funksional e volumor sikurse shembujt e mësipërm, por dallohen për tipare më të përpunuara arkitekturale, duke u larguar ndjeshëm nga karakteri rural i tyre. Duke qënë se për shkak të ekonomizimit të truallit ato marrin pjesë në formulimin e rrugës, pra nxjerrin njërën faqe të tyre në rrugë, kjo faqe, që rëndom është fasada kryesore e banesës, trajtohet më me vemendje. Kati përdhes ndërtohet kryesisht me gurë, të cilët nuk lihen krejtësisht në dukje si në rastin e banesave rurale, por fugatohen me gëlqere përreth tyre. Ky lloj fugatimi e zbut në mënyrë të konsiderueshme pamjen e muraturës, duke i hequr karakterin e vrazhdë të saj. Pamja e katit përdhe lehtësohet gjithashtu nga hapësirat e derës kryesore dhe të dritareve prej druri të banesës. Këto të fundit, në rastin më të rëndomtë, kanë shpatulla guri, ose blloqe prej gur shtuf të punuar, ndërsa hapësirat e dyerve i gjejmë të mbuluara edhe me harqe guri. Të gjitha këto i japin një karakter më të rafinuar katit përdhe.

Kati i sipërm zakonisht del pak konsol nga ai përdhes, ndoshta edhe për të fituar pak më shumë hapësirë funksionale. Dalja realizohet me trarët e ndërkatit, ndërsa muret e tyre mbi to janë të lehta, pasi ndërtohen me çatma. Thuajse në të gjitha banesat e këtij tipi në qytet këto volume të kateve të sipërme që dalin konsol shoqërohen me dritare të shumta të vendosura në rresht dhe që qarkohen nga fashatura druri. Edhe vetë këto volume shpesh qarkohen me fashatura druri në qoshet e tyre vertikale e horizontale, ndërsa në pjesën e sipërme mbyllen me strehën e gjerë të çatisë, elementët e së cilës mbartin dekorime të larmishme. Loja e volumeve të këtyre banesave theksohet edhe më tej nga kontrastet e ngjyrave të materialeve të përdorura (gur, gëlqere, dru, xham), që sëbashku me frakturën e kalldrëmit me gurë lumi me kullimet e ujërave në mes krijojnë një plasticitet piktoresk mbresëlënës përgjatë gjithë rrugës.

BANESA 1

Kjo banesë ndodhet në Lagjen e Burimeve në Pogradec dhe është një nga banesat më të vjetra që trashëgohet në këtë qytet. Banesa është me dy nivele, në formë ortogonale, duke i treguar rrugës faqen më të ngushtë të saj. Kati përdhe është me mur guri të lidhur me llaç balte dhe të përforcuar me breza horizontale druri. Përveç derës kryesore të ulët ai ka edhe dy dritare thuajse katrore të qarkuara me fashatuirë druri. Ndërsa kati i sipërm është me plitharë në faqet gjatësore dhe me çatma druri






në faqen e ballit kryesor që sheh nga rruga. Kjo faqe kryesore është pak e dalë konsol nga ajo e katit përdhe, gjë që realizohet duke u mbështetur në trarët e ndërkatit. Streha nuk është e gjerë dhe trarët e tavanit që dalin në formë bishtash janë lënë në dukje. Dritaret e katit të sipërm janë me rrëshqitje anësore, ku kanatat prej druri futen krejtësisht brenda në mes të murit prej çatmaje. Përveç kanatave të dritës (me xham) në këtë model ndodhen e dhe kanatat e plota (me panel druri), të cilat gjithashtu rrëshqasin horizontalisht duke u futur brenda në çatma. Këto mbylleshin gjatë natës, duke krijuar intimitet të plotë ndaj vështirimeve kureshtare nga jashtë. Këto dritare janë të vetmet e këtij lloji që gjenden sot në të gjithë pjesën shqiptare të bregut të Liqenit të Ohrit dhe përbëjnë një nga shembujt më të vjetër të këtij tipi në banesat tradicionale të këtij rajoni.

BANESA 2





Kjo është një banesë e ngjashme për sa i përket funksionit dhe tipit ndërtimor: banesë me dy nivele, në formë ortogonale, me faqen më të ngushtë nga rruga, ku ndodhet edhe hyrja kryesore për në banesë. Ngjashmëria ekziston gjithashtu edhe në mënyrën e konstruksionit, ku kati përdhe është i ndërtuar me gurë të lidhur me llaç balte e breza druri, ndërsa kati i sipërm me mure me plitharë dhe me ballin kryesor të ndërtuar me çatma e të nxjerrë pak konsol. Në katin përdhe, përveç derës pak të ulët ndodhet edhe një dritare me përmasa relativisht të vogla, ndërsa në katin e sipërm ndodhen tri dritare. E gjitha fasada vjen pak e transformuar, ku dallohen ndryshime të mëdha në dritaret, derën, eliminimin e fashaturave prej druri, suvatimin e plotë të mureve dhe mbulimin e strehëve.



BANESA 4

Banesa ndjek të njëjtën skemë planimetrike me korridor anësor, i cili në katin përdhe përshkon tej për tej banesën duke dalë në oborrin e pasëm. Anash tij ndodhet një dhomë, e cila ka funksionet e aktiviteteve të ditës, por përdoret edhe si dhomë dimri. Anash korridorit ndodhen shkallët me një rampë që të çojnë në katin e sipërm, në të cilin ndodhen dy dhoma gjumi. Kati përdhe është i ndërtuar me gurë, ndërsa kati i sipërm me teknikën e ëatmasë. Porta e banesës nga rruga është e mbuluar me hark me blloqe guri të punuara. Anash saj ndodhet vetëm një dritare e dhomës së dimrit, ndërsa në katin e sipërm ndodhet një rresht me katër dritare, nga dy për çdo dhomë.

Dikur fasada e banesës duhet të ketë qënë e pajisur me fashatura druri në pjesët ku ndahet muri i gurit me çatmanë, si dhe përreth dritareve. Strehët, të cilat tani janë të veshura me suva, duhet të kenë qënë të hapura, ose të veshura pjesërisht me fashatura druri.



BANESA 5



BANESA 6

Banesa ruan skemën planimetrike asimetrike dhe disa nga teknikat tradicionale, siç janë ndërtimi i mureve të katit të sipërm me çatma, dalja e trarëve të tavanit në katin e sipërm, pak sa për të mbajtur strehën e çatisë. Por është më e avancuar në përdorimin masiv të tullës në muret e katit përdhe dhe pjesërisht në ato të katit të sipërm sipas koncepteve të reja që prezantohen në vitet 1930' në ndërtimin e banesave me mur tulle. Muri i tullës është ndërtuar me kujdes, duke zbatuar teknikat e saj karakteristike në arkitrarët, kornizat, strehët, qoshet, etj. Kemi një gëshetim të teknikës së re të ndërtimit të murit të tullës me atë tradicionale të ndërtimit të çatmasë. Banesa është lënë e pasuvatuar, duke pasur besim të fortë në cilësinë e tullave. Skeleti me konstruksion druri i çatmasë është ndërtuar në mënyrë të rregullt dhe është mbushur me tulla plithari, ose qerpiçi, të cilat gjithashtu kanë rrezistuar pa u dëmtuar, megjithëse strehët janë të ngushta.



Banesat një familjare me dy nivele simetrike - Rurale

Tipi i banesës me zhvillim simetrik (korridor qendror me një ose dy dhoma anash tij në të dy nivelet) filloi të përhapej në të gjithë Ballkanin në fund të shekullit 19 dhe fillim të shekullit 20. Ky tip u parapëlqye për thjeshtësinë e tij ndërtimore e funksionale si dhe soliditetin në pamjen e jashtme. Në zonat rurale ku tradita ndërtimore ishte ende e fortë ky tip u detyrua ti përshtatej kësaj tradite, duke ruajtur teknikën e ndërtimit me gurë me breza druri horizontalë; dritaret me përmasa të vogla, por tashmë të vendosura në mënyrë simetrike ndaj aksit qendror; ballkonin e hapur, si depozitim i çardakut të dikurshëm, por që tashmë i vendosur mbi hyrjen kryesore si elementi qendror dhe më atraktiv i banesës; si dhe strehët e hapura me bishta të dekoruar, që sjellin në kujtesë ato të strehëve të mëdha të banesave të dikurshme me çardak. Këto tipare të trashëguara nga periudhat ndërtimore të mëparëshme i japin tipit simetrik një karakter të theksuar tradicional. Madje edhe kur disa dekada më vonë dritaret e vogla filluan të zëvendësohen me dritare më të mëdha, pak a shumë katrore, sipas standarteve të kohës, apo edhe kur banesat filluan të vishen jashtë me suva ky tip nuk e humbi natyrën tradicionale.



Veshja me suva të mureve të jashtëm në banesa solli si pasojë zvogëlimin e strehëve dhe mospërdorimin deri në eliminimin e plotë të bishtave prej druri. Strehët u mbyllën me korniza tulle dhe u dekoruan me profile në suva. Për ajrosjen e pjesës së brendëshme nën çati dhe të konstruksionit prej druri të saj u fut një element i ri: vrimat e ajrosjes së çatisë. Në ndërtimet e mëparëshme ajri mund të hynte lirisht nga strehët prej druri të çatisë dhe të qarkullonte nën çati. Por me mbylljen e strehëve me korniza tulle e suva qarkullimi i ajrit nuk mund të bëhej, ndaj edhe u mendua një zgjidhje për ndërtimin e vrimave për ajrosje. Në më të shumtat e rasteve muret perimetrale janë ngritur pak mbi nivelin e trarëve të tavanit (rreth 60-70 cm) dhe në këtë ngritje, para se të ndërtohet korniza e çatisë, janë lënë vrima katrore në çdo faqe të banesës. Dimensionet dhe distancat e tyre variojnë nga banesa në banesë, por gjithnjë ato ruajnë një rregullsi, duke u shndërruar në një element arkitektural dhe deri diku dekorativ në fasada.

BANESA 2 TUSHEMISHT

Edhe kjo banesë ka ardhur vetëm me 1/3 e saj në ditët tona, pasi pjesa tjetër është transformuar krejtësisht. Banesa ka apsur dikur një korridor qendror dhe nga një dhomë simetrikisht në çdo kat. Sot dritaret në katin përde janë transformuar; njëra është kthyer në derë dhe tjetra është zmadhuar. Dritaret e dikurshme duhet të kenë qënë me përmasa më të vogla se ato të katit të sipërm. Banesa nuk ka shenja për dalje konsol dhe as për hapje ballkoni, ndoshta ky mund të ketë ekzistuar në pjesën qendrore mbi hyrjen kryesore, që nuk ekziston më. Banesa është e ndërtuar tërësisht me mure guri në të dy katet. Muratura prej guri lidhet me breza horizontalë druri çdo 70-80 cm në lartësi. Qoshet e banesës janë të punuara me blloqe të rregullta dhe me imtësi. Mbizotërimi i muraturës prej guri theksohet edhe nga strehët e ngushta të çatisë, duke i dhënë banesës një pamje solide.



BANESA 3 LIN





Gjendja fillestare

Të dy shembujt e mëposhtëm përfaqësojnë rastin tipik ku një skemë planimetrike e re për kohën (korridor qendror me nga një dhomë anash) zbatohet me teknikat e ndërtimit tradicionale. Banesa e parë është ndërtuar në një terren të pjerrët, ndërsa e dyta një terren pak a shumë të sheshtë. Banesat janë ndërtuar me mur me gurë të rregullta në të dy katet, të lidhur me breza druri dhe llaç balte. Skema planimetrike është simetrike, me një korridor të madh në qendër, në fund të të cilit ndodhen shkallët për në katin e sipërm. Në banesën e parë korridori i katit të sipërm, mbi hyrjen kryesore mbyllet me një mur të lehtë (çatma), nga ku dilet në një ballkon me konstrukcion druri, të ndërtuar sipas teknikës dhe koncepteve tradicionale, të trashëguara që nga bane-



sat me çardak. Sot ky ballkon është transformuar dhe banesa është pjesërisht e shembur, por nuk është vështirë të ringremë pamjen e saj.

Në banesën tjetër muri i korrridorit të sipërm, mbi hyrjen kryesore është ndërtuar me mur guri, si vazhdim i murit perimetral të fasadës kryesore. Ballkoni që projektohet mbi hyrjen kryesore është me përmasa shumë më të vogla dhe duket se ka qënë pa strehë, pasi është prishur shpejt dhe është zëvendësuar me një ballkon me beton dhe parmakë metalikë. Transformime ka edhe në pamjet nga rruga të banesës, ku dritaret origjinale janë mbyllur dhe janë hapur të tjera me dimensione më të mëdha.




BANESA 4 TUSHEMISHT

Këto janë banesa me plan simetrik të një periudhe më të vonë, kur teknika tradicionale e mureve të lehta prej druri (çatma) nuk përdorej më dhe ishte e zëvendësuar nga ajo me mure tulle. Qoshet e banesës janë ndërtuar në forma kolonash me mur tulle, duke lënë në dukje funksionin konstruktiv të tyre në pamjet e jashtme. Trarët e ndërkatit nuk dalin më në fasadat, por në pjesën e jashtme ndërtohen korniza në nivelin e tyre. Streha e çatisë gjithashtu është e ndërtuar me korniza tulle dhe e suvatuar me profile në suva.




Një element interesant fillon të shfaqet në këtë periudhë të ndërtimit të banesave, apo kateve të tyre të sipërme krejtësisht me mur tulle. Çatia nuk ndërtohet më menjëherë mbi trarët e tavanit të katit të sipërm, por muret perimetralë ngrihen edhe pak, duke lënë vrima të vogla dhe të rregullta, në forma kuadratiqe, për të ajrosur



hapësirën nën çati. Kjo bëhet e domosdoshme kur strehët dhe hatullat e çatisë bllokohen plotësisht nga kornizat me mur tulle dhe suvaja mbi to, dhe konstruksioni i çatisë nuk ka mundësi të ajroset, duke shkurtuar jetëgjatësinë e tij. Ndërtimi i vrimave për ajrosje, duke ngritur pak muret perimetrale është një zgjidhje e zgjuar që i zgjat jetën konstruksionit prej druri të çatisë.

BANESAT 5 TUSHEMISHT

Banesat e projektuara nga ISP1 Tiranë në vitet 1970-80



Banesat një familjare me dy nivele simetrike
- Urbane

Tipi i banesës simetrike në qytet paraqitet disi më i përpunuar dhe më i proporcionuar, duke dalluar dukshëm nga i njëjti tip në zonat rurale. Edhe kur ndërtimi është kryer me materiale krejtësisht rrethanore si plitharë, apo suvatime me baltë, ai përsëri ruan një trajtim elegant të pamjeve dhe dallohet për përkujdesjen profesionale në

BANESA 1

Kjo banesë përfaqëson një nga shembujt më të vjetër në qytetin e Pogradecit të banesave me një zhvillim pak a shumë simetrik, ose më tepër me një korridor qendror dhe mjediset anash tij. Banesa vjen me transformime dhe madje në formën e dy banesave të ndara, por që jep mundësi për të lexuar formën origjinale të saj. Banesa duket qartë se dikur ka qënë e pandarë me korridorin një korridor në qendër, që përshkon banesën teje për tej duke lënë dalje në oborrin e pasëm të saj. Korridori qendror në katin e sipërm del konsol mbi të dy hyrjet, atë kryesore dhe atë të pasme.



Dalja mbi hyrjen kryesore ka një trajtim arkitektural më të përpunuar. Aty ruhen disa elementë të një çardaku të vogël, pasi ajo shërbente për shplodhje e soditje. Në funksion të kësaj është pajisur edhe me disa parmakë të vegjël por të gdhendur bukur dhe me shije, për të kënaqur syrin e banorëve. Me kalimin e kohës kjo pjesë e hapur e korridorit është mbyllur me dritare të mëdha. Kanatat janë bërë me hapje nga jashtë, për të ruajtur të paprekura pamakët prej druri dhe për të mos zënë hapësirën e brëndëshme. Më vonë banesa është ndarë në dy familje, e pronësi me dy hyrje të veçanta dhe pjesa veriore e saj i është nënshtruar një transformimi duke krijuar një dalje të katit të sipërm thuajse të njëjtë me atë të "çardakut" konsol në ish-korridorin qendror.

Edhe kjo banesë e ka katin përdhe me mur guri, i sipërmi me plitharë e konstruksion çatma në pamjen kryesore të dalë pak konsol mbi atë të katit përdhe.

BANESA 2

Kjo është një banesë e vjetër ndërtimi i së cilës duhet të jetë bërë nga fillimi i shekullit 20. Banesa përfaqëson një kombinim të konceptit të ri për atë kohë të planit simetrik, korridor qendror me dhomat anash tij, me konceptet tradicionale. Korridori në katin përdhe zgjatet deri në fund të banesës duke krijuar edhe një dalje në oborrin e pasëm të saj. Në katin e sipërm ai projektonte një ballkon të vogël mbi hyrjen kryesore, nga rruga, ndërsa në pjesën e e pasme ai projektonte një ballkon tradicional me konstruksion druri, të mbuluar me çati të mbështetur mbi kolona vertikale druri, dhe me parmakë tradicionale me pllaka druri. Muret e katit përdhe janë ndërtuar me gurë dhe të lidhur me breza druri. Ndërsa me të njëjtën teknikë në katin e sipërm janë vetëm muret anësore dhe i pasmi. Muri i katit të sipërm në fasadën kryesore është ndërtuar me tullë, i cili me sa duket ka zëvendësuar konstruksionin e lehtë çatma. Dritaret janë vendosur në mënyrë simetrike ndaj derës së ballkonit, dy në çdo anë, ndërsa ruajnë ende modelin e vjetër me katër kanata të vogla që happen nga jashtë. Është vështirë të thuhet se si ka qënë pamja e katit përdhe pa kryer sondazhe, pasi kjo sot është e transformuar,. Ka shumë mundësi që të ketë pasur vetrata të mëdha midis hapësirave ritmike që krijojnë kolonat vertikale prej druri, ku mbështetet muri me tullë i katit të sipërm. Nuk përjashtohet as mundësia që ky mur me tullë në fasadën kryesore të ketë qënë dikur me çatma. Streha e çatisë ndonëse është e mbyllur krejtësisht me murin vertikal prej tulle, del me bishta prej druri të vendosura në mënyrë të rregullt ritmike dhe të gdhendur si elementë zbukurues dekorativë. Këtu shohim se si konceptet tradicionale ruhen dhe trashëgohen ndërkohë që futen materiale teknika të reja.

Banesa ka të njëjtin plan simetrik me korridor qendror dhe dhomat anash tij. Korridori ka të njëjtin funksion me dalje në pjesën fundore për në oborrin e pasëm të banesës. Në katin e sipër korridori projektonte një ballkon mbi hyrjen kryesore, pak më të madh se në rastin e mëparshëm. Dritaret në fasadë qëndrojnë simetrikisht ndaj hyrje



kryesore në katin përdhe dhe ballkonit në katin e sipërm , nga dy për çdo dhomë. Muri ballor në katin e sipërm është ndërtuar qysh në fillim me tulle, çka tregon se konceptet tashmë kanë avancuar. Gjatë ndërtimit të tij janë lënë korniza përreth dritareve. Streha është krejtësisht e mbyllur, jo me kornizë tulle, por me bishta të dekoruara me gdhendje, që dalin në mënyrë të rregullt ritmike.



BANESAT TIP TË ISP1



BANESAT NJËFAMILJARE ME TRE NIVELE

- Banesat një familjare me tre nivele – rurale
- Banesat një familjare me tre nivele – urbane

BANESAT ME TRE NIVELE - RURALE



BANESAT ME TRE NIVELE - URBANE

BANESA 3



Kjo banesë përfaqëson një nga variantet më të zhvilluara të planit me korridor qendror dhe dhoma anash tij. Banesa është me tre kate dhe dikur i shërbente vetëm një familjeje, por është ndarë me kalimin e kohës në dy familje dhe pronësi dhe hyrje të veçanta. Korridor qendror në katin përdhe ka të njëjtin funksion me dalje në oborrin e pasëm të banesës. Në katin e sipërm ai u shërben dhomave, ndërsa në katin e tretë ai projektton një erker (dalje konsol) mbi rrugë, e cila ka shërbyer si vend për ndejtje dhe soditje. Dritaret ruajnë përmasat dhe raportet fillestare, me përjashtim të atyre në erker, të cilat janë mbyllur e transformuar. Banesa është ndërtuar me mur guri në dy katet e poshtëme dhe me konstrukcion të lehtë druri (çatma) në katin e tretë.

2. BANESAT PËR DY OSE MË SHUMË FAMILJE (VËLLAZËRISHTE) (BANESAT E MËDHA) (2 VARIANTE)

Bashkëjetesa e dy apo më shumë kurorëve të një familje lindte kërkesat për ndërtimin e banesave të mëdha. Këto mund të kenë një hyrje të vetme, por shpesh ndërtohen edhe me herë hyrje të veçantë për secilën familje, ose në shumë raste adoptimet bëhen mbasi banesa ka qënë ndërtuar. Sekemat e tyre planimetrike variojnë nga ato me të vjetrat me zhvillim të lirë, me një apo disa hyrje, ato me zhvillim vertikal dhe ato simetrike, të ndërtuara në mënyrë identike për dy vëllezër me nga dy hyrje thuajse të nejta.

BANESA ME ZHVILLIM TË LIRË (SIPAS RRUGËS)

1. Banesa e Kyçkëve

Banesa ka një zhvillim gjatësor, duke konturuar rrugën kryesore në lagjen më të vjetër të Burimeve në qytetin e Pogradecit. Banesa është dy katëshe, ku kati përdhe ka pasur funksionet e aktiviteteve tregëtare apo punishte dhe kati i sipërm atë të banimit. Banesa ka pasur tri hyrje të veçanta, të pajisura secila me shkallë për në katin e sipërm, ku ndodhen nga tri dhoma banimi për secilën familje. Ndërtimi është realizuar i gjithi thuajse me mure të lehta me konstruksione druri dhe veshje me cita e suva me gëlqere. Vetëm muret e pasëm të katit përdhe janë ndërtuar me gurë. Çatmaja mbi to është mbushur me tulla plithari, qerpiçi.



Banesa e Ickave ka pothuajse të njëjtën zhvillim të lirë planimetrik. Ndryshimi është se ajo ndodhet në degëzimin e dy rrugëve dhe plani i saj ndjek konturimin e tyre. Muret e pasëm të katit përdhe janë ndërtuar me gurë dhe të lidhur me llaç balte, ndërsa të gjitha muret e tjera në katin përdhe dhe në katin e sipërm janë ndërtuar me konstruksione druri, çatma, të veshura me listela druri dhe suva me llaç balte e patinuar me gëlqere. Banesa ka tri hyrje dhe tri shkallë që të çojnë në mjediset e katit të sipërm. Nuk mund të themi me siguri nëse çdonjera nga familjet i ka pasur mjediset e saj të ndara nga njera tjetra qysh në fillim, pasi banesa vjen me ndryshime në kohë.

Kati përdhe, i cili ka pasur funksionin e punishteve, apo dyqaneve të familjes ka qënë i pajisur me vetrata druri në pamjen nga rruga. Kanatat e drurit me xhama lëviznin vertikalisht për hapje dhe mbyllje, ndërsa për natën përdorshin qepena druri për mbylljen dhe mbrojtjen e tyre.

Kati i sipërm në faqet nga rruga ka nga një dalje të lehtë, të realizuar nga zgjatimi i kokave të trarëve të ndërkatit. Këto koka janë fshehur pasi janë të veshura me fashatura dërrase në të gjithë gjatësinë e katit nga rruga kryesore, ndërsa në daljen konsol nga rruga sekondare kokat e trarëve të ndërkatit janë në dukje. Dritaret, ndonëse në rresht, ruajnë ritmin dysh, dy dritare për çdo dhomë. Perimetri i tyre dikur duhet të ketë qënë i veshur me fashatura dërrase, tipik për dritaret në konstruksione të lehta (çatma), ndërsa më vonë janë trajtuar me korniza në suva.

Strehët e çatisë janë me bishta të gdhendura dekorativë, kjo edhe për faktin se banorët e kësaj banese kanë zotëruar gjithnjë zanatet dhe mjeshtëritë e përpunimit të drurit.

BANESA ME ZHVILLIM SIMETRIK (VËLLAZËRISHTE)

Këto banesa janë të ndërtuar qysh në fillim nga dy vëllezër, apo pjesëtarë të të njejtës familje, të cilët parapëlqejnë një plan banimi, zakonisht me korridor anësor dhe të cilin e përsërisin njëherazi në mënyrë simetrike, duke i pasur të dy hyrjet në qendër, të ndara me një mur të përbashkët. Secila familje ka të njëjtin zhvillim planimetrik: në katin përdhe hyrja me korridor anësor dhe një ose dy ambjen te anash tij. Në një krah, ose në fund të korridorit ndodhen shkallët për në katin e sipërm dhe këtu përsëritet thujtja e njëjta skemë, korridori dhe mjediset e fjetjes. Nëse kanë ballkon në katin e sipërm, ky del në qendër të fasadës, të dy mbi hyrjet kryesore dhe zakonisht është i përbashkët, por nuk mungojnë rastet kur është edhe i ndarë me parapet të ulët në mes.


1. Rurale

Kjo banesë në Lin është banesë tipike vëllazërisht. Ndonëse me pak disnivel nga rruga kryesore, banesa zhvillohet në dy nivele. Hyrjet për të dy familjet ndodhen nga rrugica e ngushtë, ndërsa në rrugën kryesore del vetëm njera faqe anësore. Secila hyrje të ëon në një korridor anash të cilit ndodhen mjediset e ndjtes, e të dimrit. Shkallët gjatësore në një krah të korridorit të çojnë në katin e sipërm, ku ndodhen mjediset e fjetjes. E gjithë banesa mbulohet me një çati të përbashkët katër ujëse. Pamjet janë të thjeshta. Pamja nga rruga kryesore është thujtja e verbër, me përjashtim të dy dritareve në dhomën fundore të katit të sipërm dhe një dritareje të vogël në një nga mjediset e katit përdhe. Mbizotëron muratura me rrshta disi të rregullt guri, e ndarë horizontalisht nga brezat e drurit. Qoshet janë me blloqe guri më të mëdha dhe më të përpunuara. Në pamjen kryesore bie në sy muratura e katit të sipërm, ku janë hapur dritaret që u japin ndriçim dhomave të fjetjes, e cila është ndërtuar me plitharë. Hyrjet janë të thjeshta dhe me të njëjtën madhësi.




BANESA LIN






Një shembull i dytë i banesës vëllazërishte me dy nivele në Lin. Ruhet thuajse e njëjta skemë planimetrike: korridori anësor me mjediset anash, të ndejtjes në katin përdhe dhe të fjetjes në katin e sipërm. Banesa ka thuajse të njëjtën vendosje ndaj rrugës kryesore, duke nxjerrë vetëm një rrëzë faqe anësore në të. Të dy hyrjet kryesore ndodhen nga rruga dytësore. Ndryshimet që ka pësuar banesa nuk na lejojnë të nxjerrim shumë përfundime mbi pamjen kryesore. Muret anësorë, të trajtuar me qoshe të rregullta edhe në fasadën kryesore, na japin të kuptojmë se muri ballor ka qënë me plitharë, ose çatma. Çatia gjithashtu është transformuar nga ndarja e pronës, nga një çati e madhe me katër kullime në dy çati më të vogla me dy kullime. Transformim kanë edhe përmasat e dritareve. Por është për tu vlerësuar cilësia e lartë e punimeve të kryera, ruajtja dhe trajtimi me kujdes i brezave të drurit, rradhëve të muraturës me gurë, trajtimi shumë cilësor i fugave, strehëve nga rruga e largimit të ujrave, të cilat kanë bërë të mundur ruajtjen e një karakteri të përgjithshëm të traditës.

Banesa në Tushemisht




Banesa ka thuajse të njëjtën skemë planimetrike: një korridor anësor dhe mjediset anash tij, si në katin përdhe ashtu edhe në katin e sipërm. Në katin përdhe ndodhen mjediset e ditës, ndërsa në atë të sipërm mjediset e fjetjes. Banesa është e ndërtuar krejtësisht me gurë, në të dy katet. Ai ndahet me breza druri horizontalë. Dritaret, jo shumë të mëdha, kanë thuajse të njëjtat dimensione në të dy nivelet. Hyrjet kanë të njëjtën madhësi në pamjen



kryesore. Mbi to projektohet një ballkon i përbashkët, i cili ze vendin qendror në pamjen e fasadës së përbashkët. Çatia është gjithashtu e përbashkët me katër kullime.

Megjithëse banesa ka pësuar ndryshime, për shkak se pasardhësit janë ndarë dhe kanë kryer secili punime sipas dëshirës, gjurmët e mbetura japin mundësi të lexohen pamjet e saj origjinale.



BANESA SHUME-FAMILJARE TE PROJEKTUARA NGA ISP1

2. Urbane






Ndërtimet urbane në përgjithësi dallohen nga ato rurale në përdorimin e teknikave dhe modeleve arkitekturalë më të rafinuara. I tillë është edhe ky shembull në rrugën buzë liqenit në Pogradec. Banesa është vendosur paralel me rrugën kryesore, pak e spostuar prej saj, duke lënë mundësinë e një oborri të ngushtë përpara, të ndarë me një rrethim me kangjella nga trotuari i rrugës. Banesa është ndërtuar nga dy vëllezër, të cilët kanë të njëjtin zhvillim simetrik me njeri tjetrin: korridor anësor dhe nga dy mjedise anash tij në çdo nivel. Banesa mbulohet me një çati të përbashkët me katër kullime. Pamja kryesore është mjaft e përpunuar. Pamvarësisht dy hyrjeve të veçanta, fasada paraqitet e unifikuar dhe simetrike ndaj një aksi qendror vertikal. Mbi dy hyrjet është janë projektuar dy ballkone, të cilët duke u bashkuar japin idenë e një ballkoni qendror në pamjen e përgjithëshme të fasadës. Dritaret si në katin përdhe dhe në katin e sipërm kanë ndriçim të bollshëm

për shkak të përmasave të mëdha. Pamjet e jashtme janë të pasuruara me korniza të shumta në suva në stilin neoklasik: strehët, ndarjet e kateve, dyert, dritaret, ballkonet, parapetet, si dhe qoshtet vertikale të banesës.

BANESA ME ZHVILLIM SIMETRIK (VËLLAZËRISHTE) ME TRE NIVELE

3. Urbane









3. Banesat komplekse

BANESAT KOMPLEKSE RURALE (3 VARIANTE: OBORR / BANESË+PELVICË / SHPAT) FSHAT

3.1.1 Stalla dhe plevica pranë banesës

3.1.2 Stalla dhe plevica mat'anë rrugës





The family house



The stables + barns

3.1.3 Stalla dhe plevica të larguara nga banesa






Lin, stable



Tushemisht, stables

2.2.4 Banesat me përdorim të përzier (Dyqan / Punishte / Biznes + Banim) (2 variante) Qytet




Dyqane me konstruksion druri



4.1 Dyqane / ose Punishte + funksionin Banim dhe me konstruksion druri




Banesa e Kyçykëve






Banesa e Ickave



Gjendja ekzituese sot.



Gjendja fillestare (restaurim virtual)

4.2 Dyqane / ose Punishte + funksionin Banim dhe me konstruksion tulle





Teknologjia duhet te diskutohet me vete

Banesat me plitharë, qerpiç.







4. BANESAT ME INFLUENCË PERËNDIMORE











Pamja kryesore, nga rruga



Pamja nga mbrapa e banesës, nga liqeni.

KAPITTULI 4

V. BUILDING TECHNIQUES, BY CATEGORIES (6)* - ELEMENTS OF THE BUILDING AND ASSOCIATED CRAFTS AND REPAIR WORKS

1. WALLS & VERTICAL STRUCTURES

MURET DHE STRUKTURAT VERTIKALE

Muret janë struktura të ndërtuara nga bashkimi i disa materialeve të veçanta, të cilat shpesh vendosen dhe lidhen së bashku me llaç. Materialet më të zakonshme në ndërtimin e mureve janë guri, druri, plithari, tulla. Muret në ndërtesa kanë për qëllim të mbajnë çatitë, dyshemetë dhe tavanet, si dhe për të mbyllur një hapësirë të caktuar si pjesë e ndërtesës, për të siguruar strehim dhe siguri. Muret në përgjithësi janë pjesa më e qëndrueshme e ndërtesës. Materialet e përdorura për ndërtimin e tyre, cilësia e llaçit, mjeshtëria, si dhe modeli, sipas të cilit bashkohen materialet, mund të ndikojnë ndjeshëm në qëndrueshmërinë e muraturës dhe aftësinë mbajtëse të saj. Muret e forcojnë ndërtesën, japin qëndrueshmëri strukturës së saj dhe ndihmojnë në kontrollin e temperaturës së brendshme. Ato ndajnë pjesën e brendshme të ndërtesës nga bota e jashtme.

Muret janë disa lloje:

Gjykuar nga aftësia mbajtëse e tyre ato ndahen në dy kategori kryesore: mure mbajtës, ose mure të trashë dhe mure ndarës, ose mure të hollë

Muret mbajtës në ndërtimet tradicionale janë:


- mure me gurë
- mure me plitharë

ndërsa në ndërtimet e shekullit 20 ndeshen edhe

- mure mbajtës me tulla

Muret ndarës në ndërtimet tradicionale janë:

- Mure të holla me konstruksione druri dhe mbushje me cita druri, plitharë ose tulla
- Mure me tulla





1. MURET ME GURË

Muret e ndërtesës, të cilat mbajnë ngarkesat janë të ndërtuara me gurë, plitharë, tulla, dhe rrallë herë me konstrukcione druri (wood framed structures). Këto mure i transferojnë drejtpërdrejtë ngarkesat nga çatia deri tek themelet. Këto mure mund të jenë të jashtme dhe të brendshme.

Trashësia e mureve mbajtës të ngarkesave bazohet në materialet e murit dhe sasinë e ngarkesës që ato duhet të mbajnë që nga kulmi. Për shembull, një mur guri me ngarkesë vetëm të një kati, në katin përldhes, mund të ketë trashësi 55-60 cm, një mur me plitharë 60-70 cm, ndërsa një mur tulle 25-38 cm. Në se ngrihen një ose më shumë kate mbi të, sipas tipit të banimit, dhe në bazë të vetive të çdo materiali trashësia e tyre mund të rritet.





Gjatë gjithë historisë guri është nxjerrë në afërsi të vendit ku bëhen ndërtimet dhe përdoret si materiali kryesor në ndërtim. Guri më i zakonshëm që përdoret në ndërtesat është guri i bardhë, pak në gri, i cili është një shkëmb sedimentar dhe që rëndom njihet si gur “kave”. Ky lloj guri është një gur shumë i fortë, i vështirë për tu punuar, kompakt dhe historikisht është përdorur për të ndërtuar themelet dhe muret mbajtës. Zakonisht ai përdoret për tu ndërtuar me rreshta, pak a shumë të rregullt, por e gjejmë edhe në mënyrë të çrregullt. Një gur tjetër mjaft i përdorshëm që gjendet në afërsi të zonave të banimit është guri “shtuf”, një gur ranor, i butë, kompakt, i cili ka një ngjyrë bezhë dhe nganjëherë vjen në nuancë gri. Ky është i përshtatshëm për të ndërtuar mure me blloqe të rregullta dhe elementë të veçantë dekorative, si qoshe, shpatulla dyersh e dritaresh, pragje, korniza etj. Nga pikëpamja fizike, ky gur ndryshon në kompaktësi dhe në forcën e tij, pasi është më i punueshëm. Nganjëherë, në vartësi të vendit ku nxirret guri dhe proceseve të sedimentimit, në



mes të shtufit gjenden pjesë shumë të forta, të cilat punohen me vështirësi. Në këto raste nga mjeshttrat popullorë ato quhen “çil” ose “doç”. Shumica e guroreve, që janë përdorur në të kaluarën, janë ende në përdorim edhe sot.

Grupet e mjeshtrave të ndërtimit në të kaluarën specializoheshin sipas proceseve që kërkonte muratura e gurit, p.sh. disa specializoheshin vetëm për ndërtimin e mureve të gurit; disa të tjerëve u kërkohej të specializoheshin në gurore për të nxjerrë gurët në përmasat që kërkohej si dhe ti prisnin ato në blloqe të mëdha e të vogla; të tjerët merreshin me transportin deri sa gurët vinin në objekt, pranë atyre që ndërtonin murin. Në objekt mund të kishte edhe gurë-gdhendës të tjerë, të cilët i gdhendnin gurët në blloqe me përmasa sipas rreshtave të muraturës, 24-26 cm të larta, ose që u jepnin formën përfundimtare blloqeve që përdorejshin në vendet e veçanta dhe në dukje (arkitratë, pragje, qoshe, etj). Krahas këtyre ishin edhe mjeshttrat e punimit të drurit, të cilët pregatisnin brezat e drurit, arkitratët prej druri, lidhjet prej druri në muraturë, vendosjen e trarëve të ndërkateve e çatisë, etj.


LLOJET E MUREVE ME GURË:

Përgjithësisht të gjitha muret ndërtohen të përforcuar me breza druri që vendosen në çdo 75-80 cm lartësi. Brenda këtyre brezave muratura mund të punohet me gurë të çrregullt ose jo, si më poshtë:


- muraturë me gurë kave, të çrregullt



- muraturë me gurë të punuar dhe me rreshta



-muraturë me blloqe gurësh të gdhendur




ELEMENTË TË MUREVE ME GURË

Brezat e drurit në muraturë

Përgjithësisht të gjitha ndërtimet me muratura guri në zonën e Pogradecit janë të pajisura me breza druri. Këto janë disa rreshta horizontalë shpesh herë me dy breza druri, një në anën e jashtme të muraturës dhe një në anën e brendëshme, të lidhura tërthori me njera tjetrën me drurë më të shkurtër, sa gjërësia e murit, dhe që vendosen horizontalisht përgjatë gjithë muraturës me gurë, në çdo 75-80 cm në lartësi. Kjo është një masë e domosdoshme për të siguruar qëndrueshmërinë e murit dhe stabilitetin e tij nga lëkundjet sizmike. Në të gjitha kërkimet tona në ndërtimet tradicionale të zonës së Pogradecit nuk pamë asnjë banesë që të mos kishte breza druri. Lidhjet tërthore në më të shumtat e rasteve bëhen me kllapa dhe përforcohen me gozhdë.

Ka edhe raste kur e gjithë hapësira horizontale e rreshtit të muraturës mbushet me breza druri. Por në mënyrë të zakonshme kjo bëhet vetëm në vendet e arkitrarëve.



Qoshet e mureve me gurë

Qoshet e mureve me gurë janë shumë të rëndësishme pasi ato janë pikat ku përfundojnë e lidhen muret me njeri tjetrin duke siguruar stabilizimin e ndërtimit. Përgjithësisht qoshet në muret e çdo ndërtese janë me blloqe guri të punuar, por ka edhe raste kur ato janë të papunuara, apo të punuara shumë pak. Në këto raste ato paraqiten si pika të dobëta dhe janë vendet ku dëmtohet më shpejt banesa, sidomos në rastet kur ka zona ku ndodhet ndërtimi i nënshtrohet lëkundjeve sizmike.

Qoshet me blloqe të gdhendura pregatiten me gurë me përmasa më të mëdha se ato të zakonshmet, që përdoren në muraturë. Ato pregatiten në blloqe të rregullta, thuajse me të njejtën lartësi dhe vendosja e tyre bëhet duke alternuar gjatësinë e gjerësinë sipas të dy faqeve të murit.

Gurët e gdhendur për qoshe përdoren edhe për të ndërtuar shpatullat e hapjeve në muret me gurë në të cilat vendosen dyert, apo dritaret. Në raste të tilla muret ndërpriten në mënyrë të rregullt duke krijuar qoshe me blloqe gurësh të skuadruar. Në hapjet edhe brezat e drurit gjithashtu ndërpriten në mënyrë të rregullt dhe jo në pak raste përpunohen edhe estetikisht, sepse ato mund të jenë të dukshme kur banesa nuk është e suvatuar nga jashtë.

2. Muret me plitharë (qerpiç)

2. Earth block walls (adobe)

Plithar/ë – Qerpiç/i – Tulla balte - Adobe





Plithari është një material ndërtimi që përgatitet nga dheu i përzier me ujë dhe elementë organikë. Teknika e prodhimit të plitharit është nga më të hershmet në historinë e ndërtimit të njerëzimit. Ajo daton që në kohët parahistorike dhe vazhdon ende sot. Plithari është një material i njohur dhe i përdorur në mbarë rruzullin dhe në shumë vende njihet përgjithësisht me emrin *'adobe'*, e cila është një fjalë arabe nga fiset berbere, e sjellë nga spanjollët në fjalorin ndërtimor modern. Në shqip fjala *'plithar'* është shumë e vjetër dhe ka pikërisht kuptimin e vetë përbërjes së materialit dhe të procesit të bërjes së tij: *'plis-i-tharë'* (*plis* - bllok dheu).

Plitharët bëhen duke përzier dheun me ujë e duke e bërë baltë. Kjo gatuhet duke e lidhur me pak kashtë, pak rërë dhe pak gëlqere. Më pas përzierja vendoset në forma, apo kallëpe dhe këto lihen të thahen në ajër të hapur. Format, apo kallëpët mund të bëhen prej druri, metali, apo çdo materiali tjetër që mund të japë formën dhe madhësinë e dëshiruar të plitharit. Pas tharjes fillestare, format, apo kallëpët hiqen për të lejuar që plitharët të thahen ngadalë (jo në diell të drejtpërdrejtë). Për të ndihmuar në reduktimin e plasaritjeve, ose çarjeve shpesh shtohet kashtë ose fibra të tjera, që janë disi të forta në tensione.

Plitharët lidhen në muraturë me llaç balte, e përzierë kjo me kashtë ose gëlqere. Plitharët mund të përdoren për të ndërtuar jo vetëm mure, por edhe kubë e kupola. Në mungesë të lagështirës plithari është një material i rezistueshëm dhe termoizolues. Ai ka gjithashtu një performancë të mirë akustike. Nëse përdoret me kujdes plithari është një material ideal ndërtimi dhe me kosto të lirë. Pothuajse e gjithë energjia e nevojshme për ndërtimin e plitharëve është puna njerëzore (indirekt e ushqyer nga dielli) dhe pas një përdorimi të gjatë, plitharët thërmohen dhe kthehen përsëri në dhé nga ku u krijuan.



Fakti se banesat më të vjetra në Pogradec, përveç gurit dhe drurit kanë si material kryesor edhe plitharin tregon se në këtë rajon deri në fund të shekullit 19, apo fillim të shekullit 20 nuk ka pasur punishte për prodhimin e tullave, por funksiononin vetëm punishtet për përgatitjen dhe shitjen e plitharëve. Kjo për arsyen e thjeshtë se prodhimi i tullave kërkonte një teknologji më të përparuar në përgatitjen e argjilës, si furra, etj.

Punishtet për prodhimin e plitharëve në territorin e Pogradecit duket se kanë qënë të shumta dhe me traditë të vjetër. Mes tyre duket se ka pasur edhe konkurrencë. Këtë e vërteton përdorimi i stampave të ndryshme që shihen rëndom në blloqet, apo tullat e plitharëve, ku çdo punishte kishte stampën e saj për të treguar prioritetin cilësor që kishin këto prodhime ndaj atyre të punishteve të tjera. Plitharët me stampa nuk i gjejmë kudo ndaj dhe prezenca e tyre në ndërtimet e vjetra në Pogradec përbën një rast mjaft interesant në historinë e prodhimit të materialeve të ndërtimit në të gjithë trevën. Nisur nga ky fakt dhe vetë prodhimi tepër cilësor i plitharëve në më të shumtën e ndërtimeve të trashëguara nga e kaluara në vendbanimet Pogradec, Lin e Tushemisht u jep këtyre vlera të veçanta dhe një vend të rëndësishëm në historinë e zhvillimit të arkitekturës së rajonit. Si të tilla këto ndërtime duhet të konsiderohen pjesë e vyer e trashëgimisë ndërtimore. Ato duhet të ruhen dhe të konservohen për të treguar konceptin e këtij materiali dhe përdorimin tradicional të tij si një pasuri teknologjike dhe shprehje e një stadi të caktuar në zhvillimin ndërtimor të këtij komuniteti.

Plithari përdoret për të ndërtuar mure perimetralë (mbajtës) dhe për mbushjen e mureve të holla me skelet druri (çatma).

Muret perimetralë të ndërtuara me plitharë zakonisht janë të trasha. Gjerësia e tyre varion nga 0.75 m deri në 1 m. Lartësia mesatare e tyre shkon nga 2.65 m deri në 3.5 m dhe në to përdoren elementë horizontalë strukturorë prej druri (lidhje) në intervale prej 75 cm për përforcimin e strukturës dhe rritjen e kapacitetit mbajtës të saj. Ndonjëherë për këtë qëllim përdoren edhe elementë vertikalë. Themelet e mureve me plitharë janë thuajse gjithmonë prej guri, me qëllim që të jenë të qëndrueshme dhe rezistente ndaj lagështirës. Këto ndërtime janë tipike në shumicën e banesave me plitharë. Në varësi të kohës së ndërtimit, elementët prej druri janë të dukshëm, si në rastin e ndërtesave më të vjetra (të shekullit 19), ose të fshehura, siç i gjejmë në banesat më të vona (fillimi i shekullit të 20-të).

Muret e lehta të mbushura me plitharë (çatma) kanë një trashësi më të vogël se ato perimetralë. Gjerësia e tyre shkon deri në 19 cm dhe ato formohen fillimisht nga një strukturë komplekse prej druri, hapësirat e së cilës më pas mbushen me plitharë. Në periudhat e mëvonëshme ato mbusheshin me tulla prej argjile të pjekura në zjarr (tullat e zakonëshme).

Three storey house in Pogradec built with mud brick walls











3. Muret me konstruksion druri / 3. Walls with timber framework

(Çatma)

Muret e holla në katet e sipërme të ndërtesave tradicionalisht janë ndërtuar me një sistem kompleks, i përbërë nga një skelet me elementë druri, hapësirat e të cilit që mbushen me materiale të ndryshme si plitharë, cita të holla druri ose tulla dhe më pas i suvatuar në të dy anët. Ky sistem konstruksioni në popull njihet me emërtimin “çatma” dhe ka qënë i përdorur në të gjithë Ballkanin deri në fillim të shekullit 20, kur ai u zëvendësua me muret prej tullash. Muret me çatma janë tipar dallues i ndërtimeve më të vjetra në zonën e Pogradecit. E veçanta e tyre në këtë zonë është se ato kanë vazhduar të ndërtohen deri në ditët tona.



Llojet e konstruksioneve prej druri

Banesat me skelet druri janë ndërtuar nga një sërë elementësh prej druri që përgatiten më parë, si ato të qo-sheve, ato kryq, të mureve, të dysHEMEVE dhe elementët e sipërm, të kulmit. Të gjithë këta elementë bashkohen me njëri-tjetrin duke e ndarë murin në hapësira të rregullta gjeometrike. Përgjithësisht në ndërtimet tradicionale të Pogradecit të gjithë elementët e drurit janë të drejtë dhe në ndërtimin e skeleteve prej druri nuk gjenden elementë të harkuar, siç i gjejmë në ndërtime të ngjashme në Europën Veriore.


Jetëgjatësia e ndërtimeve me skelete druri do të thotë që skeletet e drurit shumë shpesh duhet të përshtaten gjatë kohërave, duke krijuar forma hibride dhe jo standarde. Skeleti prej druri i çatmave zakonisht është komponenti kryesor strukturor në ndërtimin e kateve të sipërme të ndërtesës, të cilët duhet të jenë më të lehtë dhe të mos ushtrojnë pesha të mëdha mbi muret katet e poshtëm. Ai duhet të jetë gjithashtu i mbrojtur nga lagështirat dhe ujrat. Performanca strukturore e një muri, apo ndërtimi me skelet druri varet gjithashtu edhe nga fuqia dhe gjendja e nyjeve që përbëjnë skeletin. Kjo është arsyeja që në ndërtimet tradicionale të Pogradecit shihen elementë më të plotë të përdorura në qoshtet e ndërtimeve me çatma. Nga ana tjetër dështimi i një elementi druri të vetëm ose të përbashkët si rezultat i prishjes ose degradimit mund të imponojë sforcime dhe ngarkesa të paparashikueshme shtesë mbi elementët e tjera brenda skeletit. Kjo mund të çojë në shtrembërimin e skeletit dhe, në rastin më të keq, në dëmtimin e pjesëshëm të ndërtesës. Prandaj me qëllim që stabiliteti strukturor i ndërtesës të mos kërcënohet duhet kuptohet siç duhet rëndësia strukturore e mureve me skelet druri, në mënyrë që edhe riparimet ose përmirësimet që bëhen me qëllim të mirë të mos rezultojnë dëmtuese, pa dashje, apo thjesht nga mosnjohja e natyrës së tyre.

Druri që përdorej më së shpeshti për ndërtimin e skeleteve prej druri në rajonin e Pogradecit ka qënë gështenja, por nuk kanë munguar pisha e bredhi. Druri i gështenjës ka veti që mban larg për kohë të gjatë mikrorganizmat që çojnë në kalbjen e tij. Megjithatë parimet themelore që zbatohen për skeletin e drurit janë të njëjtat, pavarësisht nga llojet e drurit të përdorur, ku një ndër kryesorët është që elementët prej druri duhet të mbahen të larg lagështirës së zgjatur. Kur ka qënë e mundur të arrihet kjo, është provuar se të gjitha llojet e drurëve zgjasin me shekuj.

Skeletet prej druri ndërtohen duke vendosur fillimisht elementët kryesorë vertikalë në intervale të rregullta çdo 75 cm. Më pas vihen elementët horizontalë ndërmjet tyre, në lartësi nga dysHEMEJA prej 75 dhe 225 cm. Më pas përsëri vihen elementë më të vegjël vertikalë mbi dhe nën dritaret. Kjo çon në krijimin e hapësirave (panelet) të rregullta, të mëdha e të vogla, të kornizuara prej elementëve të drurit. Së fundi, në të gjitha hapësirat (panelet) e kornizuara vendosen elementë diagonalë, që formojnë trekëndësha, për të rritur shtangësinë e strukturës. Pra kemi një sistem ku të gjithë elementet integrohen për të stabilizuar sistemin.

Mbushjet që përdoren në ndërtimin e mureve me skelet druri tradicionalisht janë të shumëllojshme dhe të përbëra nga materialetë ndryshme. Njohja e tyre është shumë e rëndësishme, pasi nëpërmjet tyre mund të kuptohen teknikat lokale, përdorimi i tyre në kohë, materialet që kanë qënë në dispozicion në një territor të caktuar, por nuk mungojnë edhe rastet kur nëpërmjet tyre pasqyrohet gjendja sociale e ndërtesës. Prandaj është e rëndësishme që para se të ndërmerret çdo hap për riparim apo përmirësim e mureve me çatma, apo mbushjeve të tyre kurdoherë që të jetë e mundur, duhet të njihen të gjitha traditat dhe teknikat lokale të përdorura.

Në shumë ndërtesa me skelet druri, panelet që mbushen gjithashtu ka raste që mund të jenë zëvendësuar me kalimin e kohës, p.sh. ato me plitharë të jenë zëvendësuar me tulla. Në jo pak raste mund të gjenden gjithashtu disa lloje mbushje në të njëjtin mur, apo ndërtesë, që nga plitharët origjinalë, tullat e prodhimeve të para me dorë dhe ato më modernet. Këto ilustrjnë historinë e ndërtimit dhe ndryshimet në materialet dhe aftësitë që kanë qënë në dispozicion gjatë jetës së ndërtesës. Normalisht duhet të mbahen dhe ruhen si faza të historisë së ndërtesës, sigurisht me përjashtim të rasteve ekstreme, kur panelet mbushëse janë duke shkaktuar ndonjë problem në strukturën çatmasë.



5. Muret me tulla

Tulla është një material ndërtimi që përdoret për të bërë mure, trotuaret dhe elementët e tjerë në ndërtim. Tradicionalisht tullat janë bërë prej balte, siç janë tullat prej plithari, por sot termi tullë i referohet më tepër kuptimit të një njësie drejtkëndore të përbërë me argjilë, e pjekur në furrë dhe që lidhet në muraturë me llaç. Nuk përjashtohet mundësia që këtë term sot ta gjejmë edhe kur këto njësi bëhen me materiale betoni, xhami, etj. Gjithashtu sot kemi edhe tulla me materiale të lehta, ose me bira.

Historikisht tullat janë prodhuar në cilësi të ndryshme, lloje, materiale dhe madhësi që ndryshojnë sipas rajonit dhe periudhës kohore kur janë prodhuar. Tullat e pjekura janë një nga materialet më të qëndrueshme dhe më të forta ndërtimore, ndonjëherë të referuara si gurë artificialë dhe njihen të jenë përdorur qysh nga viti 4000 para Krishtit. Në rajonin e Ballkanit ato njihen qysh në kohët antike greke dhe romake, të cilët ndërtonin me tulla me përmasa të mëdha dhe i stamponin me vulat e legjioneve. Tullat kishin përdorim të gjërë edhe gjatë periudhës bizantine, ku përveç anës konstruktive ato përdorreshin edhe për dekorime të shumta në fasadat e ndërtesave e sidomos kishave. Në rajonin e Pogradecit ato i shohim të përdorura qysh në shekullin e 6 në basilikën e Linit, ndërsa gjurmë të tyre gjejmë edhe në ndërtime të shekullit 16-18.

Prodhimi dhe përdorimi masiv i tullave në Europë u rrit sidomos gjatë periudhës së revolucionit industrial, ku tullat preferoheshin si një material për ndërtime të shpejta dhe me kosto të ulët. Ndryshimi i teknologjisë gjatë shekullit 19, nga prodhimi me dorë i tullave në prodhimin e tyre të mekanizuar, rriti ndjeshëm sasinë e prodhimit dhe uljen e kostos.

Në rajonin e Pogradecit tullat e prodhuara me pjekje në furrë filluan të përdoren në fillim të shekullit 20. Shembujt më të hershëm gjenden në disa banesa në Pogradec, ku tullat mbajnë të stampuar vitin e prodhimit 1913. Këto tulla kanë dimensione standarte dhe një hapësirë të thelluar në pjesën e pasme ku është stambuar viti 1913. Ka shumë mundësi që këto tulla të mos prodhoheshin me dorë por ti përkisnin një linje të mekanizuar në qytetin e



Pogradecit, apo në rajonet pranë. Megjithatë këto tulla të datuara në vitin 1913 përbëjnë një fakt tepër të vyer për historinë ndërtimore në këtë rajon. Edhe fakti që këto tulla janë përdorur për të riparuar një ndërtesë shumë të vjetër të ndërtuar kryesisht me plitharë dhe konstruksion druri e bën më të domosdoshme ruajtjen dhe konservimin e kësaj ndërtese.

Ndërtimet me tulla të prodhuara me teknologji të mekanizuar morën hov sidomos mbas viteve 1920' me importimin e punishteve e fabrikave të vogla nga Italia. Ato ndryshuan teknologjinë e ndërtimit, duke zvogëluar ndjeshëm përmasat e mureve mbajtës, dhe duke i bërë më rezistentë muret ndarës. Futja e tullave në përdorim u shoqërua gjithashtu edhe me futjen e shumë elementëve të rinj arkitekturalë dhe dekoracione të shumta, si korniza dritarësh, dyersh, korniza në buzët e çatave, dekorime në fasada, etj.




Dëmtimet nga themelet

Themeli është elementi ndërtimor që mban ngarkesat e ndërtesave. Ai transferon ngarkesat nga muret në tokë. Madhësia e themelit është gjithmonë në proporcion me ngarkesën. Themelet bëhen zakonisht me gurë të fortë, relativisht të mëdhenj, të lidhur në ndërtesat më të vjetra me llaç balte e në ato më të vonëshme me llaç me gëlqere.

Ndryshimi i strukturës së tokës nën themele e çon në ndryshimin e strukturës të vetë ndërtesës, duke shkaktuar çarje në dysheme dhe mure në 45°. Gjithashtu, ndryshimet shfaqen në shkëputjen e lidhjeve të gurëve, shpërbërja e lidhësit të llaçit, çarjet në suva, dëmtimet e elementëve prej druri.

Shkaku kryesor për dëmtimet në themele janë ndryshimet e strukturës së tokës nën to që vjen si rezultat i:

- 1- Gabimit në ndërtimi: moskuptimi dhe mosnjohje e natyrës së tokës, cilësia e dobët e gurit të përdorur në themele - madhësi ose natyrë e tyre - ose cilësia e dobët e lidhësit të përdorur.
- 2- Përmbajtja e lartë e ujit në tokë, që çon në ndryshime të strukturës së tokës, si rezultat i cikleve të lagështirës e tharjes.
- 3- Ndryshimi i ballancës së ujit nën tokë, si rezultat i filtrimit të rrjetit të ujrave të zeza, ose i tejmbushjes së saj nga ujrati e shiut, të cilat ndryshime mund të shkaktojnë dëmtime në strukturën e tokës.
- 4- Ndryshimi i ngarkesave dhe përqendrimi i tyre, si rezultat i ndërtimeve të reja që kryhen, ose shtimi i kateve të reja, të cilat tejkalojnë kapacitetin mbajtës të themelit, ose tejkalojnë kapacitetin mbajtës të tokës.
- 5- Keq-shpërndarja e ngarkesave në themele, si rezultat i ngarkesave të përqëndruara në pika të veçanta.



Diagramat që pasojnë ilustrojnë lëvizjet më të zakonshme të çarjes, që regjistrohen në muret e thjeshtë, të ngjashëm me shumë mure ekzistues në rajon.

Në diagramin e parë, ilustrohet lëvizja e mundshme e përçarjes, që mund të ndodhë në një mur me lidhje të pamjaftueshme horizontale për shkak të ushtrimit të forcave të pjerrta, apo rënies pjesërisht të themelit, duke shkaktuar shkëmbim të materialit dhe rrezikun e vazhdueshëm për tu shembur.

Diagrama e dytë pasqyron efektet e mundshme që mund të shkaktohen në pika të ndryshme të mbështetjes në tokë të një muri të ngurtë dhe pa forcë elastike si rezultat i përbërjes së ndryshme të tokës.

Imazhi i fundit tregon efektet e mundshme që mund të pasqyrohen në murin e jashtëm të një ndërtese me "lëvizjen në bllok" të një pjese të muraturës kur toka nën themelin e saj është dëmtuar pjesërisht.

Sidoqoftë, është e këshillueshme që gjithmonë, për të interpretuar në mënyrë korrekte shkaqet dhe zhvillimet e mundshme të fenomeneve që hasen, të përdoret personeli i specializuar.

Dëmtimet nga degradimi i llaçit në mure

Një nga faktorët kryesorë në degradimin e mureve është degradimi i materialeve të tyre lidhës - llaçit. Llaçi është një material ndërtimor që përdoret për të lidhur e bashkuar me njëra tjetrën njësitë përbërëse të ndërtimit si gurët, tullat, plitharët, duke mbushur hapësirat e çrregullta dhe boshllëqet midis tyre.

Në banesat tradicionale lidhësat i gjejmë të shumëllojshëm, që nga ato më të lashtat, si balta, apo argjila, e deri tek ato më të vona me gëlqere e çimento. Lidhësat me llaç balte i gjejmë kryesisht në banesat më të vjetra. Ato përdoren për të lidhur muret me gurë, me plitharë e me tulla. Në ndërtimet më të varfëra ai përgatitej me dhë të përzjerë me pak kashtë. Por zakonisht atë e gjejmë të përzjerë edhe me pak gëlqere, e cila i jep qëndrueshmëri lidhësit. Në ndërtime të mëvonëshme hasen llaçe të përgatitura vetëm me rërë dhe gëlqere. Ndërsa mbas viteve 1930 vihet re përdorimi edhe i çimentos, teknologjia e të cilës erdhi nga Italia.



Degradimi i llaçeve në mure shkakton shembjen e tyre. Zakonisht degradimi i llaçeve vjen kur:

- llaçet janë të ekspozuara ndaj ujit dhe agjentëve atmosferikë.
- llaçet nuk janë kryer me recetat dhe përqindjet e duhura për të siguruar fortësinë në lidhje
- lidhësat organikë të llaçeve dëmtohen nga insektet dhe mikroorganizmat

Dëmtimet nga degradimi i brezave të drurit

Brezat e drurit jnaë një faktor i rëndësishëm për të garantuar qëndrueshmërinë e murit dhe jetëgjatësinë e tij. Por ato mund të dëmtohen nga shkaqe të ndryshme:

- Kur druri i zgjedhur për breza nuk është rezistent.
- Kur brezat vihen rrallë dhe ngarkesa që ushtrohet mbi të është shumë e madhe
- Kur brezat e drurit ekspozohen ndaj agjentëve atmosferikë, ujit
- Kur ato janë të ekspozuara ndaj pranisë së insekteve dhe mikroorganizmave

Në rastet kur dëmtohen brezat e drurit vihen re ulje dhe cedime të muraturës, apo deformime të saj. Muratura mund të ketë fryrje dhe inklinim nga faqet vertikale të saj. Kjo paraqet rrezik për shembje dhe paralajmëron marrjen e masave të menjëhershme.



Dëmtimet nga arkitrarët prej druri

Arkitrarët e drurit quhen brezat e druri që përdoren në mbulimin e hapësirave mbi dritaret dhe dyert në muraturë. Zakonisht me këto breza mbulohet e gjithë gjerësia e hapësirës në muraturë dhe krijohen lidhje të sigurt tërthore. Trashësia e këtyre brezave, ose arkitrarëve prej druri varion nëp proporcion me hapësirën që ato mbulojnë. Në të kundërt do të vihen re shenja deformimi nga ngarkesat, ose pesha e muraturës sipër tyre si epje, apo çarje.

Ashtu sikurse tek brezat prej druri dëmtimet në arkitrarët prej druri mund të vijnë nga:

- zgjedhja e drurit të papërshtatshëm dhe jo rezistent për arkitrarë
- përgatitja e tyre me dimensionet e papërshtatshme për hapësirën që ato mbulojnë.
- ngarkesat e mëdha që ushtrohen mbi to
- Kur arkitrarët e drurit ekspozohen ndaj agjentëve atmosferikë, ujit
- Kur ato ekspozohen ndaj pranisë së insekteve dhe mikroorganizmave

Në rastet kur vihen re epje nga linjat horizontale të tyre, kjo paraqet rrezik për shembje dhe paralajmëron marrjen e masave të menjëhershme të rritur qëndrueshmërinë e tyre.



Dëmtimet në muret me plitharë

Dëmtimet më të zakonshme me të cilat përballen muret me plitharë mund të ndahen në dy kategori kryesore: ato që kanë të bëjnë me faqet e jashtme të tyre (fasadat) dhe ato që kanë të bëjnë me kapacitetin mbajtës të tyre.

Konkretisht këto dëmtime janë:

- Shkëputja e suvasë dhe shtresës fino për shkak të lagështirës
- Gërryerja ose rënia e materialeve përbërës të plitharit për shkak të erozionit
- Pulverizimi i sipërfaqes të jashtme të plitharit për shkak të veprimit të ngricave ose kristalizimit të kripërave
- Prania e insekteve
- Rritja e bimëve, rrënjët e të cilave i shkatërrojnë shpesh muret e pa thara mirë të plitharëve
- Çarjet diagonale në planin e muraturës që krijohen nga dridhjet e tërmeteve
- Çarjet vertikale për shkak të mbivendosjes së ngarkesave të tepërta, si rezultat i përdorimeve të ndërtesës për qëllime të tjera
- Fryrja e mureve prej plithari, për shkak të shtytjeve të krijuara për arsye të ndryshme: si lëvizja e trarëve prej druri, ose e dysHEMEVE prej druri
- Prishja e trarëve dhe e dysHEMEVE prej druri si dhe e çatisë prej druri.



STRUKTURAT HORIZONTALE TË BRENDËSHME: DYSHEMETË, TAVANET

STRUKTURAT HORIZONTALE NË NJË NDËRTESE JANË DYSHEMETË E NDËRKATEVE DHE TAVANET



Dyshemetë

Në banesat tradicionale dyshemeja e katit të parë është e ndërtuar me trarë druri dhe shtresa mbi të është me dërrasa druri të afruara njera me tjetrën. Mënyra e ndërtimit të dyshemeve mund të shihet nga kati i mëposhtëm pasi zakonisht ato nuk janë të mbuluara nga tavanet. Trarët e dyshemeve në përgjithësi mbështeten në skajet e tyre mbi muret mbajtës, por kur hapësira e dhomës është e madhe vihen edhe elementë më të fortë, ose trarë me seksion më të madh në largësi rreth 2.00-2.50 metra nga njeri tjetri, qëp shërbejnë për të mbajtur trarët e dyshemesë. Konstruksioni i dyshemeve lidhet gjithnjë me muret mbajtës të katit përdhe me anë të disa trarëve horizontale prej druri, në formë brezash druri, që vendosen mbi këto mure dhe që quhen 'jastëkë'.

Trarët e dyshemeve zakonisht kanë përmasa 8x15 cm në seksionet e tyre dhe vendosen në intervale rreth 50-60 cm nga njeri tjetri. Dimensionet e trarëve përcaktohen zakonisht sipas hapësirës që ato mbulojnë dhe llojit të drurit në dispozicion. Kështu në disa hapësira të mëdha përdoren trarë të gjatë me seksione relativisht të mëdha (si 15x20, 20x20 cm). Të tilla janë edhe trarët që vendosen për të zvogëluar hapësirën e mbi të cilat mbështeten trarët dyshemesë. Dyshemeja mbi trarët, më pas, mbulohet me dërrasa druri, të cilat mbërthehen me gozhdë. Dyshemetë luajnë një rol të rëndësishëm gjithashtu edhe kundër forcave anësore, sidomos në rast të tërmeteve pasi ato lidhin të gjitha muret mbajtës e jombajtës të strukturës, sikurse edhe çatia.

Në disa banesa tradicionale në Lin gjenden edhe dysheme në të cilat shtresa e sipërme, mbi dërrasa, është ndërtuar me baltë. Mbase shtrohej balta, e përzierë me pak kashtëp për tu lodhur, fërkohej pak e lagur dhe lëmohej. Në këtë mënyrë ajo mbetej e pastër.



DysHEME me shtresë balte mbi dërrasa

Daljet konsol - ballkon (çardak), qoshk

Një element tjetër i rëndësishëm i katit të parë është qoshku, apo dalja konsol, e cila është një hapësirë që projektohet jashtë mureve perimetralë të ndërtesës. banesat tradicionale të Pogradecit kanë shembuj të shumtë të këtyre daljeve. Për të ndërtuar daljen (qoshkun) në katin e sipërm, elementët mbajtës parapregatiten dhe vendosen sipas llojit dhe zgjerimit të daljes që në fazën e ndërtimit të dyshemesë së katit. Trarët kryesorë, që do të shërbejnë për të mbajtur daljen, zgjaten jashtë mureve perimetralë, ndërsa trarët e dyshemesë vendosen mbi ta. Kur dalja është e madhe kokat e trarëve të drurit mbështeten mbi pajandime, elementë druri diagonalë që shkarkojnë forcat në murin e gurit.



Hapësirat e qoshkeve janë të përdorëshme zakonisht si element arkitekturor në banesat tradicionale dhe ato janë të llojeve të shumta. Në këndvështrimin e organizimit të hapësirës, ato janë dy llojesh, njëri kur hapësira është gjysmë e hapur, e cila është edhe zgjerimi i hapësirës së ballkonit (çardak) mbi rrugë dhe tjetri kur hapësira është e ngushtë dhe shërben për zgjerimin e hapësirës së dhomës, ose disa dhomave dhe shtrirjen e saj/tyren mbi rrugë. Projektimi gjysmë i hapur i hapësirës së çardakut mbi rrugë zakonisht është i rrethuar nga rruga me parmakë druri. Ndërsa daljet e mbyllura kanë mure të holla me konstruktion çatma dhe janë të pajisura me dritare të shumta që shohin mbi rrugë, çka i bën ato të lehta dhe brenda kufijve të mundshëm mbajtës të trarëve të dyshemesë.



Qoshk. Pogradec





Dalje konsol në të gjithë gjatësinë e banesës.



Parmakë karakteristike në banesat tradicionale në Lin.

Tavanet

Shumë banesa tradicionale nuk kanë tavane në katet përdhes, por vetëm në katet e sipërm. Tavanet e banesave tradicionale më të vjetra kanë qënë prej druri dhe në ato më të vona i gjejmë me koce kallamash dhe suva. Shtresat e tavaneve ndërtoheshin në mënyrë të ngjashme me ato të dyshemeve, por në të kundërt, duke u varur (mbërthyer) në trarët e tavanit. Tavanet e dhomave të rëndësishme zakonisht zbukuroheshin me gdhendje me motive të ndryshme, ndërsa fashatura dërrase përdoreshin në skajet e tavanit, aty ku sipërfaqja e tyre horizontale lidhej me sipërfaqet vertikale të mureve. Fatkeqësisht sot nuk ruhen shembuj të tavaneve të drurit që kanë ekzistuar dikur.

Tavanet si pjesë e elementëve dekorativë të arkitekturës tradicionale kanë qënë të larmishme për sa i përket teknikave të zbukurimit dhe të ndërtimit të tyre. Shkaku i kësaj larmie ka qënë gjithmonë fuqia financiare e pronarit, talenti i mjeshtrave dhe funksioni i dhomës që dekorohesh. Me ndërgjegjësimin e këtyre faktorëve, tipe të ndryshme tavanesh u përshtateshin preferencave për banesat tradicionale.

Ndërsa mjediset e shërbimeve në banesa zakonisht pajiseshin me tavane të thjeshtë dhe nganjëherë edhe pa tavan. Me tavane të dekoruar zbukuroheshin vetëm dhomat më të rëndësishme. Tipi i thjeshtë dhe më i përdorshëm ka qënë “tavani i sheshtë”. Në këto raste struktura që mban tavanin nuk shihet nga përdoruesi. Struktura e tavanit ka qënë e mbuluar me dërrasat e tij. Lidhjet midis dërrasave të tavanit dhe trarëve bëheshin me listela. Ornamentet tradicionale të tavanit kanë qënë të thjeshta dhe më tepër përdorshin figurat gjeometrike.

Shkallët

Shkallët janë një tjetër komponent i rëndësishëm prej druri në banesat tradicionale. Detajet e tyre të ndërtimit janë po aq të thjeshta sa elementët e tjerë strukturorë të banesës. Dy dërrasa kryesore anësore mbajnë shkeljet e shkallëve. Shkeljet kanë gjerësi përafërsisht 25cm. Lartësueset, apo riherat e shkallëve zakonisht janë 17-20 cm. Disa shkallë prej druri i kanë shkeljet prej dërrase dhe të futura me kllapa në trarët anësorë. Trarët anësorë bartin edhe ëparmakët e drurit. Nganjëherë parmakët janë elementi më i zbukuruar i shkallëve. Dekorimi i tyre zakonisht ka modele gjeometrike dhe floreale.



Shkallë banese në Lin



Shkallë banesash në Pogradec



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization



Project funded by
the European Union



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E KULTURES



ICOMOS
International Council on Monuments and Sites

